



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 14, Janar 2015

ISSN 2225-2959



ENERGJIA

Kostot, përfitimet, mundësitë.

3 vjet Bankieri





ENERGJIA

Kostot, përfitimet,
mundësitë.

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

No.14, Janar 2015
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Editorial

Energjia elektrike
Nga filozofia Carpe Diem drejt mentalitetit të reformës! 5
Elvin MEKA

Tema e ditës

Sektori i Energjisë
Sfidat dhe rrugëzgjdhjet nga një perspektivë bankare 6
Klaida ÇEKREZI (EMINAJ)
Rimëkëmbja e sektorit energjetik ka filluar 8
Damian GJIKNURI

Këndi i gazetarit

Politika e re e çmimeve
Zgjidhja e hendekut të energjisë në vend 11
Mirilda TILI

Bankieri në fokus

Nga një këndvështrim tjetër
Mendimi krijues - Atlantida e humbur! 13
Sawas THALASSINOS

Sistemi Bankar

Vlerësimi Gjithëpërfshirës drejt Bashkimit
Bankar European 14
Roberto RUOZI
Nevoja dhe koha për standarde të auditimit
të brendshëm 17
Stavri PASHKO

Forumi i Ekspertëve

Sfidat e transferimit të çmimit
Olindo SHEHU 19
Obligacionet e shoqërive aksionare
Realitet dhe burim potencial për të ardhmen 22
Enkeleda SHEHI, Flora MUSTA
Tregtarët e Tregut Parësor
Një ide (e njohur) për zhvillimin e tregut të
letrave me vlerë 25
Niko KOTONIKA, Erjon TAÇE

Këndi i Ekonomistit

Lufta e monedhave - Mit apo realitet shqetësues? 27
Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria sociale

Veprimtaritë e bankave 31
Zona e Sigurisë së Informacionit
Administrimi i sigurisë së informacionit
në strukturat organizative të bankës 36
Maks LEKSANI

Auditori Financiar

Shitja e huave (me probleme)
Një mekanizëm që krijon vlerë të shtuar për bankën 39
Evis ÇELIKU

AAB

AAB Trajnime 2014 41
AAB Trajnime 2015 42
AAB Aktivitete 43

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtore
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: PIK Creativ

Printed by: Gest-graphics

BORDI EDITORIAL:

Seyhan PENCABLIGIL
Kryetar i AAB-së & Drejtor
i Përgjithshëm i Banka
Kombëtare Tregtare

Gazmend KADRIU
Nënkryetar i AAB-së &
Drejtori i Përgjithshëm
Union Bank

Christian CANACARIS
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Raiffeisen
Bank Shqipëri

Periklis DROUGKAS
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Alpha Bank
Shqipëri

Frédéric BLANC
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Societe
Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Fibank
Shqipëri

Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme,
Shoqata Shqiptare e
Bankave

Hysen ÇELA
Kryetar i Institutit të
Ekspertëve Kontabël të
Autorizuar

Adrian CIVICI
President & Drejtor
i Shkollës Doktorale
Universiteti European i
Tiranës

Spiro BRUMBULLI
Drejtor i kabinetit të
Ministrit të Financave

Enkeleda SHEHI
Kryetare e Autoritetit të
Mbikqyrjes Financiare

Kredia Konsumatore Alpha Realizo

Kredia konsumatore **Alpha Realizo**, është kredia e cila ju mundëson plotësimin e dëshirave dhe nevojave tuaja. Ajo është ideuar enkas për të gjithë ju që dëshironi të blini mobilje të reja ose pajisje elektroshtëpiake për shtëpinë tuaj apo për të mbuluar çdo nevojë tjetër të jetës tuaj të përditshme.

- **Këste mujore të përballueshme**
- **Afat ripagimi deri në 7 vjet**
- **Kreditim deri në 300,000 ALL, pa garantues**

Për më shumë informacion na vizitoni në degët tona, telefononi në 042 240 477, ose vizitoni faqjen e internetit www.alphabank.al



TA BLESHE
APO TË MOS
E BLESHE?

Alpha Realizo
Kjo është përgjigjja!

Klientët pagamarrës: **12M BTH + 8%** Klientët standard: **12M BTH+ 10%**



ALPHA BANK



nga Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Që një industri të zhvillohet në një vend, së pari nevojitet energji elektrike; për energjinë elektrike, nevojiten punonjës të trajnuar; për punonjësit e trajnuar nevojiten disa shkolla; për shkollat nevojiten paratë; për paratë nevojiten disa industri". Ky fjalëformim zinxhir, i artikulluar nga z. Evan Davis, ekonomist, gazetar dhe prezantues i famshëm anglez i BBC-së, shpjegon në një mënyrë lakonike rolin dhe rëndësinë e energjisë elektrike. Është mëse e kuptueshme që energjia përbën një nga nevojat kryesore themelore të jetës së përditshme, e në një kuptim më të gjerë, bazamentin e gjithë zhvillimit ekonomik të çdo vendi në botë.

Kur është fjala për Shqipërinë gjithkush e pranon se vendi është i bekuar me një nga burimet më të rëndësishme natyrore: UJIN, që nënkupton energji elektrike, që është fuqi dhe pushtet, në kuptimin më të gjerë të fjalës. Për fat të keq, i gjithë ky bekim natyror nuk është transformuar në fuqi dhe prosperitet. Sistemi energjetik shqiptar dhe të gjithë aktorët e saj janë, njëkohësisht dhe të gjithë së bashku, të përballur pabesueshmërisht me sfida ekzistenciale financiare. Nëse ka ndonjë vrimë të zezë në ekonominë shqiptare, me

Energjia elektrike

Nga filozofia Carpe Diem drejt mentalitetit të reformës!

“Gjatë dy dekadave të fundit, sektori nuk përjetoi asnjëherë një reformë të vërtetë; përkundrazi, ai ka vuajtur shumë nga politikat “krijuese” dhe filozofia Carpe Diem. Rrjedhimisht, një reformë gjithëpërfshirëse e sektorit të energjisë është mëse e domosdoshme, urgjente dhe e detyrueshme, pa përmendur faktin që ajo përbën një nga përparësitë kryesore të qeverisë aktuale, e madje ajo ka filluar tashmë.”

siguri të gjithë do tregonin me gisht në drejtim të sektorit të energjisë (elektrike). Sikurse dhe vrima e zezë, ky sektor ka thithur dramatikisht, përgjatë gjithë kohës, gjithë të këqijat dhe inefficiencat e mundshme, si: keqmenaxhimin, gabimet strategjike, modelet e gabuara të tregut, ndërhyrjet politike, vjedhjet, mungesën e investimeve, përmirësimeve teknologjike dhe të reformave të nevojshme, humbjet e ndryshme, korrupsionin dhe abuzimet, keqpërdorimin e kapitalit njerëzor dhe sigurisht borxhet e këqija. Të gjitha këto kanë krijuar një peizazh surreal, ku enden plot qylaxhinj, por dhe jo pak humbës, përfshirë në këta të fundit qeverinë, qytetarët e rregullt, si dhe subjektet bartëse të kostove, si: prodhuesit e energjisë dhe bankat.

Gjatë dy dekadave të fundit, sektori nuk përjetoi asnjëherë një reformë të vërtetë; përkundrazi, ai ka vuajtur shumë nga politikat “krijuese” dhe një filozofi Carpe Diem, e cila e ka zvarritur atë dhe ekonominë në përgjithësi drejt shtegut të rrezikshëm të ekzistencës dhe kolapsit strukturor. Politikat e mëparshme jo-realiste dhe dritëshkurtër të çmimeve, si për çmimet finale për konsumatorët, ashtu dhe për çmimin e blerjes së energjisë nga hidrocentralet e vogla, kanë sfiduar pothuajse të gjitha rregullat e financës, kontabilitetit, menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe planifikimit strategjik, duke e zhvendosur zhvillimin e sektorit të energjisë jashtë parimeve të tregut. Rrjedhimisht, një reformë gjithëpërfshirëse e sektorit të energjisë është mëse e domosdoshme dhe e detyrueshme, pa përmendur faktin që ajo për-

bën një nga përparësitë kryesore të qeverisë aktuale, e madje ajo ka filluar tashmë. Kjo është megandërrhyrje kirurgjikale dhe normalisht e dhimbshme, pasi çdo gjë brenda sektorit ka nevojë për rregullim, pavarësisht faktit se ka krijuar konfuzion dhe shqetësim, në rrethin e të gjithë palëve të interesuara të sektorit energjetik, sidomos të prodhuesit e energjisë dhe bankat. Këta të fundit po shohin tani se projektet e tyre dhe planet e tyre të investimeve duhet të rishikohen e ristrukturohen, nën optikën e kursit të ri të reformave brenda sektorit. Edhe Qeveria duhet të luaj një rol këtu, në mos një rol kyç, jo për etatizëm, por për hir të ekonomisë së tregut, lojtarëve si bankat dhe prodhuesit e energjisë, e mbi të gjitha për mirëqenien e qytetarëve.

Në fakt, sa më i madh konsumi për frymë i energjisë në një vend, aq më i lartë është standardi i jetesës së banorëve të tij. Deri më sot kjo aksiomë nuk vërtetohet në Shqipëri, por qeveria ka ndërmarrë hapat e parë në këtë drejtim, me arkëtimin e faturave të papaguara të energjisë elektrike, si dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Kjo përpjekje përm-bush plotësisht thënien e njohur të Kongresmenit Republikan, z. Steve King: "Kjo është thelbësorja: zbatoni kushtetutën. Vendosni sundimin e ligjit, e më pas vjen vet kapitali dhe rrjedh energjia elektrike!"

¹ Zv.Dekan & Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET



nga Zj. Klaida ÇEKREZI (EMINAJ),
Drejtoresh e Departamentit të
Financimeve të Strukturuarave & Projekteve
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Energjia është pa dyshim një nga sektorët që kanë qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes, gjatë viteve të fundit në Shqipëri. Kjo, jo vetëm për arsye të rëndësishme të padiskutueshme të saj, si një prej nxitësve të ekonomisë, por edhe për shkak të theksit të madh që është vënë mbi këtë sektor, në lidhje me stimujt dhe skemat e ndryshme të mbështetjes, sikundër dhe për vështirësitë dhe problematikat serioze që ky sektor ka hasur gjatë rrugëtimit të tij të deritashëm.

Bankat ndoqën ritmin në treg dhe vepruan në përputhje me pritshmëritë e tregut, si dhe sinjalet pozitive qeveritare për sektorin e energjisë, si një sektor me përparësi. Deri më sot, sistemi bankar shqiptar ka akorduar për sektorin e energjisë një total portofoli huash prej rreth 500 milionë USD (tetor 2014), duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e investimeve në sektorin e energjisë, me

Sektorin e Energjisë

Sfidat dhe rrugëzgjdhjet nga një perspektivë bankare

“Sektorin mund të riorganizohet dhe përparojë pa qenë aspak një barrë për financat publike, përkundrazi, duke u shndërruar në një përfitim për komunitetin në përgjithësi, nëpërmjet qasjeve të kujdeshme dhe përdorimit të analizave të shëndosha.”

fokus të veçantë në financimin e hidrocentraleve (HEC-eve). BKT nuk mund të bënte përjashtim në këtë drejtim. Investimi në një sektor të tillë nuk ka qenë dhe nuk është një sipërmarrje e lehtë, duke pasur parasysh mungesën e njohurive të duhura në investime të tilla, pa njohuri të trashëguara në zgjidhjet e reja inxhinierike dhe perspektivës së huadhënies për këtë sektor, si dhe duke pasur parasysh specifikat e sektorit. Nga këndvështrimi i bankave, procesi është mjaft i ndërlikuar dhe vështirësia qëndron kryesisht në vlerësimin nga pikëpamja teknike e projektit, që përbën pikën më të rëndësishme, në mos atë përcaktuese, që shkon përtej kompetencës dhe aftësisë së çdo bankieri.

Gjithsesi, për sa i përket sektorit bankar, e duke u bazuar në përvojën e BKT-së në veçanti, ka treguar një rol proaktiv dhe banka është e vendosur në besimin e saj se faktori kyç i suksesit për zbatimin dhe vënien në jetë të projekteve të tilla, pavarësisht faktit që një projekt duhet të ketë parametra të mirë teknike, është integriteti i investuesit/it/ës, në kontekstin e njohurive dhe aftësisë financiare për të realizuar pjesën e tij/saj të investimeve.

Ky është një kusht i domosdoshëm, që duhet plotësuar, nëse projekte të një natyre të tillë specifike kërkohen të

realizohen dhe të jenë të suksesshëm.

Pyetja që lind menjëherë këtu është: “Pse bankat e kanë parë këtë sektor, të paktën deri më tani, si një potencial të mirë për të dhënë hua?”

Sepse në aspektin e konsumit gjithmonë ka pasur, e gjasat janë që do të ketë gjithmonë, nevojë për energji, sidomos

Nxitësit nuk duhen fshirë krejtësisht, përndryshe investimi në këtë sektor do të ndalojë. Nga pikëpamja financiare, nxitësi (stimuli) i çmimit duhet të ekzistojë, për të mbuluar koston financiare të borxhit dhe koston e kapitalit të angazhuar në investim, të paktën për një periudhë të caktuar kohe. Në këtë mënyrë, sigurohet një trajtim i paanshëm për të gjithë investuesit në HEC-et e përfunduara dhe ata nuk e gjejnë veten larg nga planet dhe pritshmëritë e tyre.

për energji të pastër, siç është dhe rasti i përdorimit të burimeve ujore. Kështu, kërkesa ekziston në treg; madje një kërkesë gjithnjë e në rritje, duke marrë këtu parasysh dhe përmirësimet në stilin e jetës në vend. Dy nga faktorët më të rëndësishëm, që kanë përcaktuar dhe fluksin e investimeve private dhe të huaja në projektet hidrike në Shqipëri kanë të bëjnë me dy stimuj të mëdhenj në këtë fushë: trajtimi preferencial në tarifatat dhe blerja e garantuar e energjisë elektrike, e prodhuar për 15 vitet e para, nga ana e shoqërisë shtetërore, KESH. Ky model lejon që projekti të jetë rentabël, pasi blerja e energjisë është e garantuar, por gjithashtu edhe stabilitet. Nuk duhet harruar se sektori karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e natyrshme operacionale, që shkaktohet nga kushtet e motit, e kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh se shumica e HEC-eve nuk kanë diga ose liqene, që mund të lejojnë një regjim të menaxhueshëm dhe stabil të ujrave dhe të ecurisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Ka pasur një debat të vazhdueshëm që këto sipërmarrje po krijojnë një barrë për sektorin publik, megjithatë, personalisht parapëlqej të përqendrohem në panoramën e plotë dhe të theksoj vlerat e shtuara, si rezultat përfundimtar i këtyre investimeve, të rregulluara përmes koncesioneve. Konkretisht, produkti përfundimtar është prodhimi i energjisë së pastër, që ul varësinë nga importet, nënkupton më shumë punësim, qasje në rrugët kryesore dhe infrastrukturë të përmirësuar, si dhe të tjera përfitime të tërthorta, që shpesh ndikojnë në riorganizimin e komuniteteve, më shumë tatime për qeverinë dhe aktive prodhuese energjetike shtesë për shtetin dhe qeverinë, që mund të zotërohen dhe administrohen prej kësaj të fundit, pas përfundimit të periudhës koncesionare 35 vjeçare. Sa për shtetin, roli i tij konsiston në kryerjen e një monitorimi rigoroz dhe të vazhdueshëm, duke siguruar se kjo pasuri e trashëguar, në fund të jetës së saj koncesionare, do të jetë produktive dhe se investimet gjatë jetës së këtyre aktiveve janë realizuar siç duhet, sikundër parashikohen dhe nga kontratat koncesionare.

Sfidat që hasen nga ana e investuesve dhe bankave lidhen me pagesat e prapambetura, që KESH u detyrohet hidrocentraleve të vogla. Kjo ka krijuar probleme likuiditeti, veçanërisht kur merret në konsideratë nevoja për të shlyer pagesat e huave, si dhe shpenzimet e tjera operative. Likuiditeti është kritik për veprimtarinë e përditshme operacionale, sikurse dhe në çdo lloj biznesi, apo sektori. Për më tepër, shpesh investuesit në HEC-e i krijojnë shtrëngesa edhe likuiditetit të shoqërive të tyre investuese, që u ofrojnë kapital qarkullues HEC-eve, për të përmbushur detyrimet respektive.

Nisur nga pengesat aktuale, pyetja që pashmangshmërisht mund të bëjë gjithkush është: “Si do të vijohet më tej?” Personalisht do të konsideroja dy pika të rëndësishme, si një mënyrë për të kuptu-



Produkti përfundimtar i HEC-eve është prodhimi i energjisë së pastër, që ul varësinë nga importet, nënkupton më shumë punësim, qasje në rrugët kryesore dhe infrastrukturë të përmirësuar, si dhe të tjera përfitime të tërthorta, që shpesh ndikojnë në riorganizimin e komuniteteve, më shumë tatime për qeverinë dhe aktive prodhuese energjetike shtesë për shtetin dhe qeverinë, që mund të zotërohen dhe administrohen prej kësaj të fundit, pas përfundimit të periudhës koncesionare 35 vjeçare.



ar më mirë procesin, e në përpjekje për t'i dhënë përgjigje çështjeve të mëposhtme:

1. Zgjidhja e shtrëngesës së likuiditetit, nëpërmjet shlyerjes së pagesave të prapambetura ndaj prodhuesve të energjisë;

2. Përcaktimi i një qasje përfundimtare për mënyrën se si do të vijojë të funksionojë sektori, duke pasur parasysh formulën dhe strukturën e çmimit.

Lidhur me pikën e parë, ndërmarrja e “masave shtrënguese” nga qeveria, në

drejtim të grumbullimit të faturave të papaguara të energjisë elektrike dhe ndaj debitorëve të energjisë është një qasje premtuese që ndihmon në këtë aspekt, veçanërisht nëse ndiqet një procedurë buxhetimi racionale, lidhur me administrimin e këtyre “fonde shtesë” që mblihen, si dhe kanalizimin e një pjese të këtyre të ardhurave në formën e pagesave për energjinë e prodhuar nga hidrocentralet e vogla.

Pasi të zgjidhet pika e parë, ka një nevojë për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Personalisht, besoj se nxitësit nuk duhen fshirë krejtësisht, përndryshe investimi në këtë sektor do të ndalojë, sikundër besoj gjithashtu se, nëse reforma është e domosdoshme, atëherë duhet zbatuar një trajtim i diferencuar midis enteve operative dhe koncesioneve të reja. Nga pikëpamja financiare, nxitësi (stimuli) i çmimit duhet të ekzistojë, për të mbuluar koston financiare të borxhit dhe koston e kapitalit të angazhuar në investim, të paktën për një periudhë të caktuar kohe (këshillohet, për shembull, që kjo periudhë të lidhet me afatin e maturimit të huas, e cila është e krahasueshme me periudhën e shlyerjes së investimeve). Një trajtim i tillë mund t'u jepet vetëm hidrocentraleve, ku investimi ka përfunduar dhe janë funksionale, ose në rastet kur kuota e investimit është mbi një nivel caktuar. Nëse ndryshimi i tarifës do të jetë i domosdoshëm, ky ndryshim duhet minimalisht të zbatohet gradualisht, për të shmangur goditjet ndaj sektorit dhe pasojat e mëtejshme në sektorin bankar, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me investime të tilla. Ndërkohë, për ata që hyjnë rishtas në këtë sektor, kushtet mund të rishikohen dhe nxitësit edhe mund të hiqen, në përputhje me modelimin përfundimtar të sektorit; nëse investuesit shohin një mundësi biznesi, atëherë le ta ndjekin atë. Trajtimi transparent dhe marrëveshjet e qarta janë vendimtare për një vendimarrje sa më të drejtë. Sektori mund të riorganizohet dhe përparojë pa qenë aspak një barrë për financat publike, përkundrazi, duke u shndërruar në një përfitim për komunitetin në përgjithësi, nëpërmjet qasjeve të kujdesshme dhe përdorimit të analizave të shëndosha.



nga Z. Damian GJIKNURI

Ministër
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Sistemi energjetik për një vend është i krahasueshëm me kapilarët e gjakut në trupin e një njeriu. Energjia është në zemrën e veprimtarisë sociale dhe ekonomike të shoqërive të industrializuara dhe atyre në zhvillim, duke prekur çdo qytetar në jetën e tij të përditshme. Një sistem energjetik “i plagosur” është natyrshëm një varr i hapur për ekonominë e vendit. Nëse hemorragjia nga kapilarët e gjakut rrezikon jetën e njeriut, hemorragjia e sistemit energjetik është e destinuar ta marrë me vete të gjithë ekonominë e vendit drejt humnerës. Ndaj, reforma në sistemin energjetik hyn në listën e reformave të dhimbshme, jo popullore e tejet të vështira, por mbetet domosdoshmëri. Sa më e papërgjegjshme të jetë sjellë politika me sektorin, aq më e vështirë bëhet reforma. Në afro një vit e gjysmë qeverisjeje u përballëm me një sektor thujtë të falimentuar, kemi arritur

Rimëkëmbja e sektorit energjetik ka filluar

Viti 2015 mund të konsiderohet viti i reformave dhe i investimeve më të mëdha në sektorin energjetik. Pasi u ndalua rrënimi dhe hemorragjia mbeten shumë sfida përpara në rrugën e gjatë drejt shëndoshjes dhe rimëkëmbjes së plotë të sistemit energjetik.

të mbyllim plagët më urgjente dhe me kënaqësi konstatoj se rimëkëmbja e sektorit energjetik tashmë ka filluar.

KU E NISËM...

Sektori u gjet i zhytur në një krizë të plotë operative dhe financiare, me borxhe të ndërsjella dhe hua bankare të pashlyera. Borxhet zinxhir mes operatorëve OSHEE, KESH dhe OST arrinin në vlerën mbi 1.1 miliardë USD. Vula e privatizimit të dështuar të sistemit të shpërndarjes kishte lënë shenjën e saj në të gjithë sektorin. Shteti shqiptar ishte i paditur në Gjykatën e Arbitrazhit nga CEZ, e rrjedhimisht, i gjithë sektori ishte i marrë peng.

Qeveria e shkuar nuk bëri asgjë për mbrojtjen ligjore të palës shqiptare, duke humbur kohë të vlefshme dhe thujtë betonuar shanset e çekëve për të dalë me sukses në procesin gjyqësor. Pavarësisht “muajve të mjaltit” apo mërive të qeverisë së kaluar me çekët, shpërndarja e energjisë mbeti me një nivel humbjesh mesatare vjetore (gjatë 2013-ës) që arrinte në 45%, ku arkëtoheshin vetëm 77% e faturave të lëshuara, ndërsa niveli i arkëtimit të faturës ishte vetëm 67%. Edhe në një situatë ideale, me arkëtimet 100% dhe

humbjen jo teknike 0%, sistemi sërish prodhonte rreth 8 miliardë lekë deficit. Gjithashtu, qeveria e shkuar shiti edhe pesë hidrocentrale, duke e rënduar bilancin ekonomik të sektorit. Modeli i dështuar i tregut, sikurse dhe kontratat koncesionare të pastudiuara e jo të pasqyruara në kosto për prodhuesit e vegjël privatë, ishin një kontribut i vazhdueshëm për thellimin e krizës financiare. Përkeqësimi i furnizimit me energji për konsumatorët ishte pasoja më e dukshme, për shkak të mungesës së gjatë të investimeve, ndërkohë që mbi

Qeveria ka nisur shlyerjen e borxheve të prapambetura ndaj prodhuesve të vegjël të energjisë, si dhe është në një proces dialogu me ta, për të gjetur një formulë afatgjatë të përcaktimit të një çmimi, që merr në konsideratë interesat e prodhuesve të vegjël, por dhe ato të shtetit.

80 % e rrjetit të shpërndarjes është me vjetërsi mbi 35-40 vjeçare, rreth 25% e linjave të tensionit të mesëm ishin tërësisht të amortizuara dhe 20% e kabineve gjithashtu kishin nevojë urgjente për ndërhyrje.

ÇFARË ARRITËM TË BËJMË...

Me mbështetjen e plotë të Bankës Botërore, FMN-së dhe Komunitetit të Energjisë u bë e mundur arritja e një marrëveshjeje për zgjidhjen e konfliktit me çekët e CEZ. Zgjidhja e konfliktit përmes një procesi transparent i hapi rrugën kryerjes së investimeve shumë të domosdoshme dhe afrimin e investuesve të huaj seriozë. Qeveria arriti të mbyllë me sukses negociatat me Bankën Botërore, për financimin me 150 milionë USD të projektit për rimëkëmbjen e sektorit energjetik. Këto fonde do të përdoren për kryerjen e investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë, duke synuar uljen e humbjeve dhe përmirësimin e furnizimit me energji në të gjithë vendin. Investimi do të fokusohet në ato qarqe dhe zona që kanë konsumin më të madh si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Fieri apo Vlora. Qeveria angazhohet të ulë humbjet në sektorin e shpërndarjes me 5% në vit, me objektiv në vitin 2019 prej 15%. Mënyra e menaxhimit të shoqërive të sektorit elektroenergjetik u transformua, me synim sjelljen e tyre në parametrat e tregut, duke i bërë njëkohësisht më llogaridhënëse dhe efektive. Për herë të parë pas 24 vitesh, me mbështetjen e fortë të Kryeministrit Z. Edi Rama, i kemi dhënë jetë një operacioni jetik të rivendosjes së ligjshmërisë në konsumin e energjisë elektrike, që nuk do të jetë periodik, por puna e përditshme dhe e vazhdueshme e OSHEE-së.

Institucionet buxhetore kanë filluar të japin shenjat e qarta të një transformimi drastik në qasjen për detyrimet ndaj OSHEE-së. Ndryshimet e kryera në Kodin Penal kanë ashpërsuar dënimet për rastet e krimeve kundër rrjetit energjetik, pra tolerancë zero për këdo që vjedh dhe abuzon me energjinë elektrike, pa asnjë lloj dallimi. Qeveria ka refuzuar amnistinë, e bindur se kjo praktikë ka shërbyer për gërryerjen e sistemit dhe jo shëndoshjen e tij, duke ofruar një skemë lehtësuese e të përballeshme për

shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Paralelisht me ndëshkimin e konsumatorëve që kanë guxuar të vënë dorë në mënyrë kriminale mbi sistemin energjetik, mbi 60 faturistë dhe elektrikistë janë ndëshkuar për abuzim me detyrën. Një element thelbësor është natyrshëm reforma e kryer në strukturën e tarifave, ku përfshihet dhe heqja e bllokut prej 300 kWh për konsumatorët familjarë dhe vendosja e një tarife unike. Përmes kësaj reforme do t'i jepet fund abuzimit me "fashën e hajdutërisë", duke marrë në mbrojtje njëkohësisht përmes një mekanizmi të sigurt, mbi 210 mijë familje në nevojë.

Ndërkaq, figurojnë aktualisht 164 kontrata koncesioni për ndërtimin, apo

rehabilitimin e 435 HEC-eve. Fuqia totale e instaluar për to arrin në 1,930 MW, prodhimi vjetor i parashikuar në total 345,087 GWh dhe investimi total shkon rreth 2 miliardë e 654 milionë euro. Deri më tani kanë hyrë në punë rreth 70 kontrata, me mbi 100 hidrocentrale, energjia e të cilave blihet prej KESH-it. Qeveria ka ndërhyrë dhe në tarifën me të cilën KESH blen energjinë e prodhuar nga HEC-et private. Formula e re e përcaktuar nga qeveria bazohet te çmimi mesatar i Bursës së Hungarisë, plus nxitësin 10%. Kjo formulë e sjell çmimin e energjisë së blerë nga këto hidrocentrale më afër tregut, shmang tarifën e deformuar të importit dhe i jep frymëmarrje KESH-it.



Reforma në sistemin energjetik hyn në listën e reformave të dhimbshme, jo popullore e tejet të vështira, por mbetet domosdoshmëri. Në afro një vit e gjysmë qeverisjeje jemi përballur me një sektor thuasje të falimentuar, kemi arritur të mbyllim plagët më urgjente dhe me kënaqësi konstatoj se rimëkëmbja e sektorit energjetik tashmë ka filluar.



RIMËKËMBJA SAPO KA FILLUAR....

Operacioni për rivendosjen e ligjshmërisë në konsumin e energjisë elektrike ka arritur rezultate të dukshme. Niveli mesatar vjetor i humbjeve për vitin 2014 u mbyll me 37.81% ndërsa një vit më parë ky tregues ishte 45.04%, pra, me ulje prej 7.2%, që është më e madhja, nga arësimet për vitin 2014 janë 100 milionë USD më shumë se sa një vit më parë e u arrit të mblidhen 49.1 miliard lekë, ndërsa një vit më parë u mblodhën vetëm 38.4 miliardë lekë. Me fillimin e këtij viti, ky operacion do të intensifikohet edhe më tej duke synuar konsolidimin e ligjshmërisë. Këtë vit fillon projekti i transformimit të menaxhimit të OSHEE-së, për të garantuar një shërbim më cilësor për qytetarët. Përmes huas së Bankës Botërore, por dhe fondeve të vet shoqërisë, do të fillojë kryerja e investimeve të domosdoshme në rrjet, për të garantuar sigurinë energjetike. Po punohet intensivisht për ndërtimin e linjës 400 kV të interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës, ndërsa vazhdon përmirësimi i linjave të brendshme, ku përfshihet dhe projekti i rëndësishëm i linjës 110 kV të Unazës së Jugut.

Qeveria ka nisur shlyerjen e borxheve të prapambetura ndaj prodhuesve të vegjël të energjisë, ku brenda muajit prill do të likuidohen të gjitha borxhet e vitit të kaluar, ndërsa do të paguhen edhe faturat aktuale ndaj tyre. Ndër-

kohë, jemi në një proces dialogu me këta investues, për të gjetur një formulë afatgjatë të përcaktimit të një çmimi, që merr në konsideratë interesat e pro-dhuesve të vegjël, por dhe ato të shtetit. Baza e re ligjore, e miratuar nga qeveria do të fillojë zbatimin deri në arritjen e një formule, që garanton çmim sa më pranë tregut dhe investimet private. Për të asgjësuar efektin negativ që mund të ketë kjo situatë, sipas pretendimit të prodhuesve të vegjël, qeveria ka shprehur gatishmërinë për të zgjidhur afatin e këtyre kontratave koncesionare me 5 vite të tjera. Gjithashtu, qeveria ofrohet e gatshme të luajë rolin e ndërmjetësit, mes prodhuesve dhe bankave, me synim që ata të rristrukturojnë huat, për të zgjidhur kohën e shlyerjes. Qeveria është mbështetëse dhe nxitëse e investimeve për shtimin e burimeve energjetike, por ajo do të jetë transparente, për t'i bërë të qartë qytetarëve se ka dy rrugë në të cilat mund të ecet. E para është ajo e shtimit të burimeve të reja energjetike, të cilët kanë një kosto që duhet pasqyruar diku, e kjo nënkupton se qytetarët do duhet të paguajnë më shumë për energjinë, me synim shtimin e këtyre burimeve të reja. E dyta është ajo e vazhdimin të varësisë nga importi dhe shfrytëzimi i burimeve aktuale energjetike.

Gjykoj se rruga më e drejtë është shtimi i burimeve të reja energjetike, por duke qenë transparent me qytet-

arët, e duke mos ia faturuar koston në fshehtësi Buxhetit të Shtetit dhe KESH-it, siç ka ndodhur gjatë viteve të fundit. Masat e marra nga qeveria synojnë rritjen e likuiditetit në sektor dhe nxjerrjen e tij nga kriza financiare. Qeveria ka miratuar dhe shumë shpejt do të kalojë në Kuvend ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike, në të cilin sanksionohet ndryshimi i modelit të tregut dhe nisja e procesit të liberalizimit të sektorit të energjisë, duke nisur nga klientët e lidhur në tensionin e mesëm. Kjo pjesë do të dalë nga skema e rregulluar dhe deri në vitin 2018 do të kemi afro 30% të tregut të energjisë të liberalizuar. Ky proces dhe zhvillimi paralel i rrjetit të transmetimit me Kosovën, e më pas me Maqedoninë, do të rrisin mundësitë për tregtinë e energjisë nga prodhuesit e vegjël privatë. Në plan afatgjatë qeveria po punon për të shfrytëzuar gazjellësin TAP, me synim diversifikimin e burimeve energjetike në vend. Siç dihet, në sajë të fondit të siguar nga Bashkimi Europian, me mbështetjen e qeverisë së Azerbajxhanit dhe shoqërisë shtetërore SOCAR do të mund të hartohet masterplani i gazifikimit të Shqipërisë.

Viti 2015 mund të konsiderohet viti i reformave dhe i investimeve më të mëdha në sektorin energjetik. Pasi u ndalua rrënimi dhe hemorragjia mbeten shumë sfida përpara në rrugën e gjatë drejt shëndoshjes dhe rimëkëmbjes së plotë të sistemit energjetik.

TRYEZË E RRUMBULLAKËT ME MINISTRINË E ENERGJISË DHE INDUSTRIË, 11 DHJETOR 2014.

AAB, në bashkëpunim me Këshillin Ekonomik Kombëtar organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave anëtare, ministrin e Energjisë, si dhe përfaqësues të KESH-it dhe OSSHE-së. Gjatë takimit u diskutua mbi ndryshimet e fundit dhe masat e ndërmarra nga Ministria e Energjisë në lidhje me prodhuesit privatë të

energjisë, si dhe shqetësimet e bankave, si huadhënësve të këtij të fundit lidhur me shumën e papaguara që KESH dhe OSSHE i detyrohen atyre, të cilat nga ana e tyre kanë krijuar hua të papaguara për bankat. Takimi u fokusua në burimet e mundshme që do të shfrytëzohen për t'i siguruar KESH-it likuiditetin e nevojshëm dhe përfshirjen e mundshme të bankave.





Politika e re e çmimeve

Zgjidhja e hendekut të energjisë në vend

■ ■ Në diskutimet e fundvitit mbi çmimet e energjisë elektrike, qeveria vendosi barazimin e çmimit të blerjes së energjisë nga KESH nga prodhuesit vendas me çmimin e kuotuar në Bursën e Hungarisë.

Cmimi i energjisë elektrike u rrit. Duke përfshirë edhe taksat që një konsumator familjar do të paguajë, çmimi shkon 11,4 Lek/Kwh. Por a do të mund kjo rritje të mbyllë “gropën” që është shkaktuar tashmë prej vitesh, ku vetëm shifrat zyrtare flasin për një humbje mbi 150 euro në vit? A do të mund të sjellë kjo rritje e çmimit për konsumatorët çlirim të prodhuesve të vegjël në Shqipëri, që të mund të paguajnë në kohë huat e marra? Në mbledhjen e fundit të Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë, që u pohua se: “Për herë të parë OSHEE ka një plan të detajuar investimi dhe menaxhimi të punëve në sektorin shpërndarës të energjisë”. Është disi e habitshme se, si gjatë kaq viteve ku shteti i detyrohet bankave të nivelit të dytë mbi 500 mijë euro çdo vit si garanci për blerjen e energjisë, të mos ketë ekzistuar asnjë plan investimi apo mbledhje faturash. Në diskutimet e fundvitit mbi çmimet e energjisë elektrike, qeveria vendosi barazimin e çmimit të blerjes së energjisë nga KESH nga prodhuesit vendas me çmimin e kuotuar në Bursën e Hungarisë. Ky vendim solli reagim të menjëhershëm nga ana e prodhuesve, sipas të cilëve kjo do të sillte një shtrëngim shumë të madh, deri në falimentim, pasi detyrimet që ata kanë ndaj bankave janë shumë të mëdha. Fakt është që bankat kanë qenë mbështetësit e tyre të vetëm dhe vijojnë të shihen edhe si mundësia e tyre për mbijetesë. Rritja

në 11% e peshës të totalit të prodhimit të energjisë nga HEC-et e vogla rrezikohet për shkak të vendimit të qeverisë për të ulur çmimin e shitjes me 30%.

Aktualisht vlera e investuar për HEC-et e vogla janë 250 milionë euro dhe të ardhurat për këto biznese janë rritur me 200%, në tre vitet e fundit. Mbi 80 HEC-e të vogla janë në prodhim këtë vit dhe dhjetëra të tjerë pritet të vihen në efikasitetin që vjen. Korporata e Elektroenergjetike (KESH) ka dështuar të blejë me 9 lekë kilovatin e energjisë nga këto HEC-e, duke akumuluar rreth 51 milionë euro detyrime e ky borxh, që është një nga disa hallkat e zinxhirit të detyrimeve të krijuara në sistemin elektroenergjetik shqiptar, e ka çuar qeverinë drejt vendimit të çmimit të blerjes së energjisë nga KESH prej katër HEC-eve, rreth 30% më të ulët për këtë vit që sapo ka filluar. Në kushte të tilla, rrezikohen seriozisht me falimentim rreth 60 HEC-e të vogla, pasi shumica e tyre janë ndërtauar me hua bankare dhe plane biznesi të bazuar mbi çmimin 9 Lek/Kwh, të paktën për 10 vitet në vijim. Natyrshëm lind pyetja: A e ka Shqipëria luksin që në kontekstin e një situatë komplekse ekonomike, të vërë para falimentit një nga sektorët e paktë prodhues në vend?

IMPORT APO PRODHIM?

Vitin që shkoi, importi i energjisë kushtoi mesatarisht 6,8 (euro) cent, ose 8,4 Lek/Kwh, nivel ky gati i përafërt me çmimet e

blerjes ndaj HEC-eve të vogla. Shqipëria ka harxhuar në dekadën e fundit mbi 1,2 miliardë euro për import energjie, ose 10% të PBB-së. Gjatë 10-vjeçarit të fundit, thatësira e gjatë vuri në vështirësi prodhimin e energjisë; nga ana tjetër, nevojat e konsumit po rriteshin në nivele dyshifrore dhe çështja “energji” ishte kthyer në një rrezik serioz për stabilitetin makroekonomik të vendit. Përpos kësaj, burimet e rritjes së ekonomisë po shteronin dhe kapacitetet e pashfrytëzuara të burimeve ujore u panë si mundësia më e mirë për t’i dhënë zhvillimit të ekonomisë një drejtim tjetër. Perspektiva paraqitej e mirë për shkak se, konsumi i energjisë është me rritje kolosale dhe çmimi i energjisë hidro po rritet me ritme të shpejta. Për t’i dhënë një nxitje prodhimit vendas të energjisë, qeveria e mëparshme fiksoi një nivel çmimi 9 Lek/Kwh ndaj prodhuesve koncesionarë. E parë vetëm nga ky këndvështrim, politika konsiderohet e suksesshme, pasi HEC- et vogla deri në 15 MW arritën një nivel të ardhurash prej 30 milionë eurosh më 2013 (duke përfshirë HEC-Ashtën që është një investim i huaj dhe ka një kapacitet më të lartë prodhimi). Tani kur nuk kanë kaluar as tre vite prodhim nga këto HEC-e, qeveria po rishikon politikën e çmimit, duke vënë në dilemë ekzistencën e 260 milionë eurove investime vendase (me gjithë investimet e huaja shuma arrin në 400 milionë euro, sipas të dhënave nga Shoqata e Energjisë së Rinovueshme).

nga Zj. Mirilda TILI



Disa gjëra duken të zakonshme



Deri sa të zbulosh mundësitë **extra**

- BLERJE ME KËSTE ME 0% INTERES
- BONUS NË DYQANET PARTNERE
- BLERJE FALAS ÇDO DITË



KARTA E MUNDËSIVE
EXTRA





nga Z. Savvas THALASSINOS

Drejtor i Përgjithshëm¹
TIRANA BANK

Tani më shumë se kurrë, të menduarit krijues duhet të marrë frenat në një organizatë funksionale. Megjithatë, duket sikur ai nuk po merr ende vendin që i takon. “A duhen bërë gjërat siç duhet, apo duhen bërë gjërat ndryshe?” Pa dyshim, Kozmosi u vu në lëvizje kur atij iu dha një shtysë, pra kur papritur gjithçka ndryshoi rrënjësisht, në mënyrë të pazakontë, të çuditshme dhe përtej normales. Është pikërisht ky përkufizimi i risisë, si produkt dinjitoz i të menduarit krijues: pra diçka që lind apo përdoret për herë të parë. Kjo është e ashtuquajtura arritje apo triumf, e admiruar njëherë e një kohë, pasi ajo krijoi thelbin dhe vlerën e shtuar. Kjo është e Atlantida e humbur!

Ngjarjet socio-ekonomike të gjysmës së fundit të dekadës së kaluar kanë evoluar në një mënyrë të tillë që, na kanë detyruar të heqim dorë nga të menduarit krijues. Unë mund të guxoj të them se, në disa raste, të menduarit krijues organizativ mund të jetë “i padëshiruar”, apo “i rrezikshëm”. Fokusi tashmë është i përqendruar në rregullat dhe rregulloret e

Nga një këndvështrim tjetër Mendimi krijues - Atlantida e humbur!

Risia ka qenë themeli i qytetërimit të suksesshëm dhe guri themeltar i sipërmarrjes. Por, risia në thelb është rezultat...është produkt i të menduarit krijues.

rrepta. Interpretimet “robotike” të këtyre rregullave dhe rregulloreve janë bërë tashmë normë, si dhe po shndërrohen në disiplinën “e duhur”. Këto përbëjnë tani kontekstin! Këto nxjerrin në pah kufijtë e lejuar, si dhe përcaktojnë “kutinë”! Por a nuk zë fill mendimi krijues, pikërisht aty ky vet të menduarit kërcën jashtë “kutisë”? Rrjedhimisht, të konsiderosh mendimin krijues si një normë, është thjesht paradoksale! Po çfarë nuk shkon në këtë peizazh? A është kjo një çështje zgjedhjeje midis rregullave dhe qasjes krijuese? A është ky një diskutim midis teknokratëve dhe krijuesve të tregut? Më e sakta do të ishte të pohohet që kjo është tashmë një çështje baraspeshë, ose më mirë një çështje e mungesës së baraspeshës, ku “çfarë është e drejtë”, ka nxjerrë jashtë funksionit atë “çfarë është e ndryshme”.

Le t'i bëjmë gjërat sipas radhës: Së pari të njohim e më pas të ndryshojmë! *Ndryshimi* nevojitet për të rifituar konkurrueshmërinë e humbur. Por *Ndryshimi* kërkon dikë që t'i shohë gjërat çdo ditë nga një perspektivë e re. Por kjo është një çështje e kulturës organizative (dhe personale). Nga një këndvështrim tjetër, zgjidhjet e ndryshme, kanë të bëjnë me mjedisin e organizatës dhe frymën që mbizotëron në të. Nëse nuk ekziston, gjykimi ndryshe duhet të vendoset si një enë që përmban me të menduarit krijues. Ajo vijon të prodhojë një perspektivë të ndryshme dhe kënde alternative gjykimi, e kjo mund të bëhet vetëm kur lejohet elasticiteti në mendime. Kjo është arsyeja pse shumë ide të mira, apo zgjidhje të problemeve të vështira, lindin në dush, në një lojë futbollit, apo jo çuditërisht edhe gjatë gjumit, pra kur mendimi i pandërgjegjshëm mbizotëron dhe punon me fleksibilitet e në mënyrë produktive.

Bankat, si çdo organizatë tjetër pa përjashtim, duhet të rishikojnë dhe përshtatin stilin e punës, në mënyrë që të rifitojnë shkëlqimin e tyre, si dhe të zbatojnë thirrjet për ndryshim, duke

nuhatur vazhdimisht mjedisin rrethues. Me qëllim që të ripozicionohen në zemër të veprimtarisë ekonomike dhe nxisin rritjen, ato duhet të gjejnë një mënyrë të re të të bërit të gjërave, përtej metodologjive të rrepta teknokratike të viteve të fundit. Kjo është arsyeja pse të menduarit krijues duhet rimishëruar në kulturën organizative, që nëpërmjet fuqizimit të strukturave të mund të:

- rivendosë një kontakt efektiv me shoqërinë dhe më gjerë, me mjedisin e saj. Një proces i ri komunikimi do të mund të lejojë rindërtimin e besimit. Kjo nuk është vetëm domosdoshmëri, por një parakusht për një marrëdhënie të re ciklike, që nxit zhvillimin dhe rritjen,

- sugjerojë një partneritet të ri konsultues, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e huadhënies, mbi bazën e një projekti konstruktiv. Bankat i zotërojnë aftësi të tilla të transferueshme, që plotësojnë ose mbështesin sipërmarrjen dhe nismat e biznesit privat, mbi baza të shëndosha. Një marrëdhënie e tillë të çon në një rritje ekonomike me përfitim reciprok.

- ripërcaktojë ofrimin e shërbimit ndaj shoqërisë, përtej shërbimit të thjeshtë bankar. Banka duhet të pranojë se, njohuritë e specializuara dhe informacioni duhet të fuqizojë faktorët e veprimtarisë ekonomike, për të vepruar me urtësi dhe vetëdije. Po kështu, bankat duhet të rimendojnë modelin e tyre dhe të konsiderojë se si mund të jenë një “one-stop shop”, që lidh pikat nga A në ZH. Bankat janë të afta të bëhen tempujt e dijes dhe informacionit, apo jo?

Risia ka qenë themeli i qytetërimit të suksesshëm dhe guri themeltar i sipërmarrjes. Por risia në thelb është rezultat...është produkt i të menduarit krijues. Le t'i thërrasim të menduarit lateral dhe ta drejtojmë organizatën drejt risive, ndryshmeve, të ndryshmes, drejt kufijve të rinj, drejt... rritjes.

Të menduarit krijues të shpërblen!

¹ Deri më 31.12.2014



nga **Z. Roberto RUOZI**

Professor emeritus
UNIVERSITÀ BOCCONI DI MILANO

Në 26 tetor të vitit 2014, Banka Qendrore Europiane (BQE) publikoi rezultatet e Vlerësimit Gjithëpërfshirës (CA), i cili përfshinte Vlerësimin e Cilësisë së Aktiveve (AQR) dhe Provat e Rezistencës (Stress tests) për bankat. Ky vlerësim kishte si objektiv kryesor ekzaminimin e nivelit të mjaftueshmërisë së kapitalit të 130 bankave të mëdha në vendet Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU). AQR-ja u përqendrua në analizën e qëndrueshmërisë reale të zërave kryesorë të bilancit të bankave (kryesisht huat dhe letrat me vlerë), duke analizuar dhe vlerësuar rrezikun që përmbajnë ato. Këto vlerësime u krahasuan me vlerat me të cilat këto aktive janë regjistruar në bilancet e bankave dhe gjetjet përfundimtare i referoheshin mungesës së kapitalit, si rezultat i mbivlerësimeve të mundshme kontabël të zërave të aktivitetit, përkundërt vlerave të llogaritura nga BQE-ja. Nga ana tjetër, provat e rezistencës vlerësuan rezultatet që situatat e

Vlerësimi Gjithëpërfshirës drejt Bashkimit Bankar European

Vlerësimi Gjithëpërfshirës ka krijuar kushte thelbësore për një fillim të qetë të Mbikëqyrjes Europiane, e cila nga 1 nëntori 2014 ka zëvendësuar autoritetin kombëtar, për bankat më të mëdha në vendet e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, e që shpresohet se do të ndiqet me hapa konkretë të mëtejshëm, drejt arritjes së Bashkimit Bankar European.

ardhshme ekonomike (2014-2016), të karakterizuara nga vështirësi të veçanta të mjedisit ekonomik (ndërmjet të tjerave edhe një rënie e fortë ekonomike), mund të prodhojnë në bilancet e bankave. Për më tepër, këto prova vlerësuan dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave, aq të nevojshëm për të kapërcyer lehtësisht vështirësitë ekonomike dhe ato të kapitalit, të shkaktuara nga skenarë të tillë. Edhe në këtë rast, rezultatet evidentuan mungesa të mundshme në kapitalin e bankave të veçanta, nëse ndodhnin situata të tilla ekonomike.

Vlerësimi Gjithëpërfshirës ishte një hap i rëndësishëm drejt Bashkimit Bankar European dhe në përgjithësi rezultatet ishin pozitive. Faktikisht, vetëm 13 banka nuk i kaluan këto prova. Katër prej tyre, të cilat pas një analize të parë dukeshin në një gjendje kritike, kanë ndërmarrë me të vërtetë hapa konkrete për të pastruar bilancet dhe për të rritur kapitalin në periudhën midis datës së kryerjes së provave (31.12.2013) dhe datës së publikimit të rezultateve të tyre (26.10.2014). Si rrjedhim, edhe ato nuk paraqesin më mungesa kapitali.

Në kontekstin shqiptar mbetet e rëndësishme të theksohet se, asnjë nga të nëntë bankat, që do të duhej të korrigjonin mangësitë e identifikuar të kapitalit, nuk është e pranishme në

Shqipëri, e për këtë arsye sistemi bankar shqiptar nuk ka pse të ndikohet nga rezultatet e Vlerësimit Gjithëpërfshirës. Të nëntë bankat problematike të sipërpërmendura do të duhet të marrin masa sa më shpejt, si nëpërmjet planifikimit të rritjes së mjaftueshme të kapitalit, ashtu dhe nëpërmjet kërkimit të bankave të forta, me të mund të bashkohen. Në këtë kuptim, Vlerësimi Gjithëpërfshirës përfaqëson një mjet të dobishëm, për të fuqizuar përqendrimin bankar në vendet e EMU-së.

Në kontekstin shqiptar mbetet e rëndësishme të theksohet se, asnjë nga të nëntë bankat, që do të duhej të korrigjonin mangësitë e identifikuar të kapitalit, nuk është e pranishme në Shqipëri, e për këtë arsye sistemi bankar shqiptar nuk ka pse të ndikohet nga rezultatet e Vlerësimit Gjithëpërfshirës.

Rezultatet e Vlerësimit Gjithëpërfshirës u mirëpritën nga bankat europiane. Ato që i kaluan provat i konsideruan rezultatet provave si normale dhe të pritshme; bankat që nuk i kaluan dot ato, nuk mbetën as të habitura. Në një farë mënyre, ishte thujtë e qartë se cilat ishin bankat që zotëronin aktive me shumë rrezik, ose me kapital të pamjaftueshëm. Megjithatë, pati komente të ndryshme rreth Vlerësimit Gjithëpërfshirës dhe ato i referoheshin kryesisht metodologjisë së përdorur në llogaritje, si dhe cilësisë së skenarëve për provat e rezistencës, që u gjykuan si shumë të rënda dhe jorealiste. Një tjetër fakt i kritikuar ishte ai që letrat me vlerë të borxhit sovran, të përfshira në bilancet e bankave, u konsideruan se bartnin rrezik. Gjithashtu, u pranua si i arsyeshëm argumenti për të përdorur të njëjtin model llogaritje për të gjitha bankat, në të gjitha vendet e analizuara, por u evidentua gjithashtu se në këtë mënyrë, bankat dhe vendet që janë shumë të ndryshëm mes tyre, u trajtuan njëjloj, ndërkohë që duhej të ishin marrë parasysh karakteristikat e veçanta të secilit prej tyre. Një nga faktet e kritikuar fort ishte ai i mosmarrjes parasysh në llogaritje i veprimtarisë së pastër financiare, si: derivatet, të cilët rëndojnë në madhësi të ndryshme mbi rreziqet e bankave të veçanta, e as ndihmat shtetërore që bankat kanë marrë përpara provave të rezistencës, e që për hir të faktit janë të ndryshme për banka të ndryshme. Ato shkojnë nga më shumë se 200 miliardë euro për bankat gjermane, në vetëm 4 miliardë euro për bankat italiane.

Gjithsesi, dobësia më e madhe e provës së rezistencës qëndron në faktin se ato morën në konsideratë vetëm nevojat për kapital dhe cilësinë e aktiveve, duke neglizhuar problemet e likuiditetit, e sidomos aspektet e eficiencës dhe përfitueshmërisë, të cilat nuk janë dytësore, gjatë procesit të gjyqimit mbi shëndetin e bankave të veçanta. Megjithatë, ato janë të lidhura me kapitalin, me ndikim kryesisht në të ardhmen.

Me perspektivë nga e ardhmja, shtrohet pyetja nëse ekuilibrat e rivendosur të kapitalit për shumicën e bankave europiane mund t'u japë mundësi atyre të rifillojnë plotësisht funksionet e tyre të huadhënies, duke mbështetur kështu rritjen ekonomike, që në vendet e EMU-së, duket e vështirë për t'u nxitur.



Nga kjo pikëpamje, mendohet se këto ekuilibra nuk janë të mjaftueshëm. Sigurimi i ringjalljes së huasë për ekonominë, kërkon dy elemente të tjera të domosdoshme. E para është rritja e kërkesës për hua, veçanërisht nga bizneset, e cila duket ende larg, pavarësisht nga disa shenja të dobëta, që mund të dëshmojnë për disa lëvizje pozitive, edhe në periudhë afatshkurtër. E dyta është vullneti dhe aftësia organizative e shumë bankave, të cilat për vite me radhë e kishin lënë pas dore sektorin e huadhënies, në të cilin faktikisht kanë shënuar humbje shumë të rëndësishme, e që nuk duket të jetë ende gati për t'u angazhuar në huadhënie, më shumë sesa niveli aktual. Më tej, mbetet gjithmonë në fuqi fakti që, huat thithin një pjesë të konsiderueshme të kapitalit, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat rregullatore të mbikëqyrjes, e kjo vazhdon të dekurajojë me forcë huadhënien.

Aspekti pozitiv është se tani nuk jemi në gjendjen e disa viteve më parë, kur bankat europiane dëshmonin gjithashtu një mungesë të burimeve për të investuar në hua. Tani situata ka ndryshuar dhe likuiditeti i bollshëm, i vënë në dispozicion të bankave nga BQE-ja me norma interesi afër zeros,

mund të përdoret realisht jo vetëm për të nënshkruar obligacione qeveritare, siç ka ndodhur në të kaluarën, por edhe për rifillimin e financimit të ekonomisë reale.

Siç mund të shihet, vërejtjet e bëra kohë më parë, janë të natyrës së përgjithshme. Nga kjo pikëpamje, Vlerësimi Gjithëpërfshirës nuk solli diçka të re. Kontributi i tij më i madh ishte në periudhën që i parapriu kryerjes së Vlerësimit Gjithëpërfshirës, kohë kjo gjatë të cilës bankat u përshtatën në mënyrë spontane (duke realizuar pas-trimin e sipërpërmendur të bilanceve dhe rritjen e kapitalit), në mënyrë që të paraqiteshin në një gjendje të mirë gjatë datës së “provimit”. Në këtë kuadër, ai ishte shumë më i dobishëm se Vlerësimi Gjithëpërfshirës, i kryer disa vite më parë, por rezultatet e tij duhet të vlerësohen për atë që janë, pa i ekzagjeruar, as pozitivisht e as negativisht. Megjithatë, nuk ka dyshim se ai ka krijuar kushte thelbësore për një fillim të qetë të Mbikëqyrjes Europiane, e cila nga 1 nëntori 2014 ka zëvendësuar autoritetin kombëtar, për bankat më të mëdha në vendet e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, e që shpresohet se do të ndiqet me hapa konkretë të mëtejshëm, drejt arritjes së Bashkimit Bankar Europian.

CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, Ilogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405



nga Z. Stavri PASHKO

Drejtor Ekzekutiv
INSTITUTI SHQIPTAR I AUDITUESVE
TË BRENDSHËM (AIIA)

S sektori bankar në Shqipëri është një nga sektorët e paktë në të cilin mund të flitet dhe të preket një temë si mirëqeverisja e korporatave. Prania e funksioneve si: menaxhimi i rrezikut, këshilli drejtues, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm - shtylla të rëndësishme për qeverisjen e korporatave - janë sinjale pozitive dhe shpresëdhënëse. Gjithsesi, prania nuk mjafton. Në mbarë botën zhvillimi i këtyre funksioneve është në qendër të vëmendjes prej dekadash, kurse në Shqipëri jemi ende në fazën e njohjes, me zbatime të cekëta dhe ende në maturim. Ndërsa vrapohet drejt globalizimit, është i pashmangshëm zhvillimi më dinamik i qeverisjes së korporatave dhe mekanizmave të sipërpërmendura.

Prania e hershme e funksionit të auditimit të brendshëm në banka është sanksionuar pikësisht nga kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë, në veçanti

Nevoja dhe koha për standarde të auditimit të brendshëm

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm ekzistojnë që të ndihmojnë profesionistët e auditimit të brendshëm të zhvillojnë me sukses punën e tyre. Ato shërbejnë si një busull orientimi, ndërsa audituesit e brendshëm udhëtojnë mes paqartësive, kërkesave dhe sfidave që përfshin profesioni.

nga rregullorja: “Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja”. Kjo rregullore, pavarësisht se nuk është hartuar veçanërisht për auditimin e brendshëm, jep disa parime bazë për vendosjen dhe mbarëvajtjen e funksionit. Duke vetënjohur kufizimin e saj, rregullorja udhëzon gjithashtu të ndiqen rregullore dhe procedura të brendshme të bankave, për çështje të pa trajtuara nga kjo rregullore.

Në këtë kontekst, nuk është e vështirë që zhvillimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në mjedise të ndryshme organizative të marrë orientime të ndryshme. Kështu, shtohet gjithmonë e më tepër paqartësia mbi veprimtarinë. Kjo paqartësi jorealiste mund të sjellë pretendime dhe kërkesa nga ana e përdoruesve të auditimit të brendshëm, siç është menaxhimi i lartë. Këto pretendime dhe kërkesa mund të largojnë, me dashje apo padashje, auditimin e brendshëm të luajë rolin që i përket.

Përveç përdoruesve të brendshëm si: bordi dhe drejtuesit, shërbimet e auditimit të brendshëm po përdoren gjithmonë e më shumë nga përdorues të jashtëm, siç mund të jenë: gjykata (në raste krimesh ekonomike), auditues të jashtëm, apo organe të tjera mbikëqyrëse. Këta për-

dorues kanë gjithashtu nevojë të kenë siguri që veprimtaria e auditimit të brendshëm ka kryer punën në përputhje me standarde të larta cilësie dhe profesionalizmi.

Nga ana tjetër, vetë zbatuesit e profesionit, audituesit e brendshëm, kanë nevojë për udhëzime më të qarta dhe më universale, sesa praktikrat e ndjekura në banka të ndryshme. Rritja

Auditimi i brendshëm është një veprimtari siguridhënie dhe këshillimi, e pavarur dhe objektive, e projektuar për të shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e organizatës. Ajo ndihmon organizatën të përmbushë objektivat, duke sjellë një përjasje sistematike dhe të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.



e tyre profesionale nuk mund të jetë e plotë nëse kufizohet vetëm nga njohuria organizative dhe rreziku për të arritur në një gjendje amullie është mjaft i lartë.

Në këto rrethana, është e pashmangshme nevoja për një standardizim të profesionit. Në fund të fundit, nuk duhet të jetë diçka krejtësisht e papritur. Profesionet të ngjashme me profesionin e audituesit të brendshëm, si: auditimi i jashtëm dhe kontabiliteti, udhëhiqen nga dhe ushtrohen në përputhje me standardet përkatëse.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm janë të hartuara dhe publikuara nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm, i njohur në shkallë ndërkombëtare si zëri i profesionit të auditimit të brendshëm. Ata janë një kuadër konceptual, që jep parime dhe udhëzime për zbatimin dhe promovimin e profesionit të auditimit të brendshëm. Si të vetmet standarde të njohura në rang ndërkombëtar, prej dekadash këto *Standarde* janë në përdorim në shumë industri dhe organizata, në sektorin privat apo publik. Këtu mund të përmendim institucione të njohura si: Komisionin Europian, Komitetin e Bazel-it, si dhe me qindra organizata dhe banka ndërkombëtare. Madje edhe shumë banka mëna të bankave që ushtrojnë veprimtari në vendin tonë, u referohen këtyre standardeve, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm, brenda mjedisit të tyre organizativ. *Standardet* janë të rëndësishëm për të gjithë palët e përfshira në auditimin e brendshëm: përdoruesit si dhe zbatuesit.



Një veprimtari e auditimit të brendshëm e zhvilluar në përputhje me *Standardet*, u jep siguri gjithashtu dhe përdoruesve të jashtëm, mbi nivelin e ecurisë dhe cilësinë e punës së auditimit të brendshëm. Në këtë mënyrë, puna e audituesve të brendshëm mund të shërbejë si referencë e besueshme dhe cilësore, me përfitueshmëri nga palët të ndryshme.



Quis custodiet ipsos custodes?

Veprimtaria e auditimit të brendshëm, krahas të tjerave, kryen kontrole në perimetrin e të gjithë bankës, për të t'i dhënë siguri palëve të interesuara mbi mbarëvajtjen e proceseve dhe menaxhimin e rrezikut. Por kush jep siguri objektive mbi mbarëvajtjen e vetë auditimit të brendshëm? Drejtuesit dhe komitetet e auditimit nëpër banka, si përdorues kryesorë, kanë nevojë të kenë një pamje më të qartë mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm. Ata duhet të kenë siguri që fokusi i auditimit të

brendshëm është në të njëjtin drejtim me objektivat e institucionit përkatës. Gjithashtu, ata duan të dinë më shumë mbi efektivitetin, por mbi të gjitha, mbi eficiencën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Standardet i pajisin drejtuesit dhe komitetin e auditimit me një sistem vlerësimi, për të matur efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ata tregojnë qartë se çfarë duhet të bëjë auditimi i brendshëm, në mënyrë që të jetë efektiv. Gjithashtu, *Standardet* promovojnë auditimin e bazuar në rrezik, si një mënyrë për të dhënë vlerën e duhur dhe për të trajtuar çështje të lidhura me eficiencën e veprimtarisë.

Një veprimtari e auditimit të brendshëm e zhvilluar në përputhje me *Standardet*, u jep siguri gjithashtu dhe përdoruesve të jashtëm, mbi nivelin e ecurisë dhe cilësinë e punës së auditimit të brendshëm. Në këtë mënyrë, puna e audituesve të brendshëm mund të shërbejë si referencë e besueshme dhe cilësore, me përfitueshmëri nga palët të ndryshme.

STANDARDET PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM

Standardet dhe një kuadër profesional janë tiparet që bëjnë të dallueshëm një profesion nga një grup i pastrukturuar njerëzish, që zhvillojnë funksione të ngjashme. Vetë termi “profesionist” përfshin “*të vepruarit sipas standarteve teknike dhe etike të një profesioni*”.

Standardet u shërbejnë audituesve të brendshëm për shmangur pritshmëri të padrejta dhe shmangie nga një punë dhe ecuri cilësore. Midis të tjerash, ato hedhin dritë qartë mbi përgjegjësinë e audituesit të brendshëm, promovojnë pavarësinë dhe objektivitetin, si tipare kyçe të auditimit të brendshëm dhe rregullojnë marrëdhënien e profesionit me palët e treta. *Standardet* Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm ekzistojnë që të ndihmojnë profesionistët e auditimit të brendshëm të zhvillojnë me sukses punën e tyre. *Standardet* janë hartuar nga auditues të brendshëm për audituesit e brendshëm. Ato shërbejnë si një busull orientimi, ndërsa audituesit e brendshëm udhëtojnë mes paqartësive, kërkesave dhe sfidave që përfshin profesioni.



nga Z. Olindo SHEHU

Partner i Taksave dhe Çështjeve Ligjore
DELOITTE ALBANIA DHE KOSOVA

Zhvillimet e shpejta të teknologjisë, transportit dhe komunikimit kanë ndikuar në rritjen e numrit të shoqërive ndërkombëtare që kanë fleksibilitetin për të organizuar sipërmarrjen dhe veprimtarinë kudo nëpër botë. Tashmë një vëllim domethënës i tregtisë globale ka të bëjë me transferimin ndërkombëtar të të mirave dhe shërbimeve, kapitalit dhe aktiveve jo-materiale (të patrupëzuara), si p.sh. pronësia intelektuale, brenda grupit. Mund të sillen plot fakte që dëshmojnë se transaksionet brenda grupit po rriten në mënyrë të qëndrueshme dhe tashmë arrijnë në afro 30 për qind të transaksioneve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se një numër i madh i transaksioneve ndërkombëtare nuk qeverisen më tërësisht nga forcat e tregut, por edhe nga forcat që nxisin interesat e

Sfidat e transferimit të çmimit

Transferimi i çmimit mbetet një nga elementët më të sofistikuar të legjislacionit të tatim – taksave, në nivel ndërkombëtar. Metodatat e transferimit të çmimit janë të ndërlikuara dhe përfshijnë angazhimin e ekspertizës më të kualifikuar fiskale, ligjore dhe ekonomike

përbashkëta të subjekteve brenda të njëjtit grup.

Kjo prirje ndërkombëtare ka pasur ndikimin e vet edhe në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e konsiderueshme e pagesave prej shoqërive shqiptare, kundrejt shoqërive të huaja brenda kornizave të shërbimeve menaxheriale, teknike etj. Një situatë e tillë theksohet sidomos në kushtet e krizës globale. Nisur nga arsyet e boshllëqeve ligjore, si administrata tatimore në Shqipëri, ashtu edhe shoqëritë lokale nuk kanë mundur të “sfitojnë” faturimet e marra nga grupi, në rastin kur këto faturime mund të kenë qenë edhe të mbingarkuara, apo përtej çmimeve të tregut. Përcaktimi i çmimit të duhur, që quhet “çmimi i transferueshëm” për transferimin e produkteve apo shërbimeve mes palëve të lidhura brenda grupit, është detyrimi ligjor që ka munguar në Shqipëri e që trajton këtë problematikë.

Mbetet e rëndësishme të theksohet se, transferimi i çmimit në vetvete nuk përfshin domosdoshmërisht shmangien nga detyrimet tatimore. Transaksionet ndërkombëtare, të cilat prekin shtete të ndryshme me ekonomi të ndryshme dhe norma tregu, jo gjithmonë fort të ngjashme, e bëjnë konceptin e transferimit të çmimit në bazë të “vlerës së tregut” shumë herë më të

vështirë sesa në rastin kur këto transferita ndodhin brenda të njëjtit shtet. Me fjalë të tjera, edhe pse shmangia e tatimeve mund të mos jetë thellësisht qëllimi i çmimeve të vendosura për produkte, apo shërbime të ofruara nga shoqëri rezidente në shtete të zhvilluara (psh: Gjermani, Austri, etj.), duke marrë parasysh kushtet e tregut në Shqipëri, këto çmime mund të duken të ekzagjeruara dhe të japin përshypjen e një mbingarkese artificiale. Ndërkohë, në realitet janë çmime të bazuara në një treg, që është ndryshe nga ai i Shqipërisë.

Siç mund të vihet re, transferimi i çmimit mbetet një nga elementët më të sofistikuar të legjislacionit të tatim – taksave, në nivel ndërkombëtar. Metodatat e transferimit të çmimit janë të ndërlikuara dhe përfshijnë angazhimin e ekspertizës më të kualifikuar fiskale, ligjore dhe ekonomike.

Përveç ekspertizës, që duhet të jetë e shkallës më të lartë, si nga ana e administratës tatimore, ashtu edhe nga ana e tatimpaguesve apo konsulentëve të tyre, një ndër çështjet më sfiduese në këtë drejtim do të jetë identifikimi i çmimit të tregut, për transaksionet që do të zbatohen në marrëdhëniet me grupin nga ana e degëve dhe filialeve përkatëse në Shqipëri. Tatimpaguesit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë prova që faktojnë se këto çmime



☎ 04 22 34 096 @ www.bankacredins.com ✉ shitja@bankacredins.com

Është gjithmonë mirë kur dikush kujdeset për ty!

Për të gjithë ju që keni një depozitë apo një Kartë Visa të Credins Bank, përfitoni:

Ulje
deri në
40%
në ekzaminim
mjekësor



Sigurimi i jetës
dhe shëndetit

FALAS
për një vit





janë në nivelin e tregut dhe anasjelltas, për administratën tatimore. Një gjë e tillë mund të jetë e thjeshtë në rastin e çmimeve të kuotuarra, por në rastet kur mungon informacioni publik në dispozicion të tatimpaguesve dhe institucioneve tatimore, si për shembull: në rastin e produkteve apo shërbimeve të specializuara, apo në rastin e shërbimeve të konsulcencës, evidentimi nëse këto çmime janë me vlerë tregu bëhet edhe më i vështirë.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, legjislacioni i parë në lidhje me transferimin e çmimit u fokusua mbi industrinë farmaceutike dhe ato të hidrokarbureve. Sot, në rang botëror, disa prej transaksioneve më të mëdha midis shteteve kryhen midis degëve të ndryshme të bankave ndërkombëtare dhe shoqërive të sigurimit. Megjithatë industria financiare ka veçantitë e saj, për qëllime të dispozitave të transferimit të çmimit, ndryshimet nuk janë të mëdha. Faturimet për shërbimet menaxheriale, që bën një shoqëri mëmë ndaj shoqërisë bijë në sektorin prodhues, në parim ndjekin të njëjtin koncept që ndiqet në sektorin financiar. Për rrjedhojë, edhe metodologjia e ndjekur, në bazë të rregullores së OECD-së, është mëse e zbatueshme edhe në rastin e bankave apo të shoqërive të sigurimit.

Megjithatë, ka disa transaksione të cilat janë unike në industrinë

financiare, e që kërkojnë një zbatim më të specializuar të legjislacionit të transferimit të çmimit. Instrumente financiarë, të cilët dalin jashtë atyre tradicionale p.sh: derivatet, risigurimet dhe të tjera transaksione, të cilat janë të bazuara në rrezikun që merr secila palë e transaksionit, bëhen tepër të vështira për t'u vlerësuar në bazë të metodave tradicionale të transferimit të çmimit. Kjo, sepse është e vështirë të bëhet një vlerësim i kostos që ka secili rrezik që merret përsipër nga palët. Si rrjedhojë, meto-



Transferimi i çmimit në vetvete nuk përfshin domosdoshmërisht shmangien nga detyrimet tatimore. Transaksionet ndërkombëtare, të cilat prekin shtete të ndryshme me ekonomi të ndryshme dhe norma tregu, jo gjithmonë fort të ngjashme, e bëjnë konceptin e transferimit të çmimit në bazë të "vlerës së tregut" shumë herë më të vështirë sesa në rastin kur këto transferta ndodhin brenda të njëjtit shtet.



dat e transferimit të çmimit bazuar në kosto bëhen shumë të vështira për t'u zbatuar në transaksione, që si bazë kryesore kontraktuale kanë transferimin e rrezikut. Ekzistojnë metoda alternative, që janë edhe më të ndërlikuara dhe që bazohen në ndarjen e fitimeve midis palëve në një transaksion (metoda "profit split" ose metoda "transactional net margin"), por zbatimi i këtyre metodave kërkon udhëzime të specializuara, për të arritur në rezultate relativisht të pranueshme për tatimpaguesit, por edhe për administratën tatimore.

Në tregun aktual në Shqipëri, dhe në sektorin financiar në veçanti, transaksionet me palë të lidhura përbëhen më së shumti nga shërbimet menaxheriale, zhvillime të software-ve, shpërndarje kostosh dhe konsulenca të ndryshme. Në rastet kur transaksionet janë më të ndërlikuara, do të nevojitet angazhim më i plotë nga të gjithë "aktorët", të tillë si: institucione financiare, administratë tatimore dhe/ose konsulentë të jashtëm ekspertë në transferimin e çmimit, për të arritur në metoda zbatimi që do të nevojiten edhe në të ardhmen.

Zbatimi korrekt i këtij legjislacioni gjatë hapave të tij të parë do të jetë me shumë rëndësi, për të hedhur baza të shëndosha për të ardhmen. Dispozitat e transferimit të çmimit, në rast se zbatohen në mënyrë korrekte, i japin degëve dhe filialeve lokale instrumente me anë të të cilave ato mund të negociojnë më mirë me grupin, madje mund të luftojnë për të shmangur mbifaturimet, si dhe për të ruajtur në këtë mënyrë normat e tyre të fitimit. Në këtë kontekst, degët mund të fuqizojnë pozitën e tyre në grup, në krahasim me kohën përpara zbatimit të këtij ligji. Në të njëjtën kohë, administrata tatimore mund të mbrojë ecurinë e vendit, duke luftuar mbifaturime të mundshme nga shoqëri jo-rezidente.

Përtej sfidave, zbatimi me sukses i këtij legjislacioni do të sjellë përfitime të shumfështa, si për degët dhe filialet e shoqërive të huaja, ashtu edhe për administratën tatimore, buxhetin e shtetit dhe ekonominë në tërësi.

Zhvillimi i tregut të obligacioneve është aktualisht në krye të axhendës së punës për rregullatorët dhe industrinë e letrave me vlerë. Për këtë arsye, Organizata Ndërkombëtare e Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe Organizata Rajonale Europiane (CERS/ESMA) po punojnë aktivisht për një rregullim sa më të plotë të këtij tregu, duke i kushtuar rëndësi rritjes së transparencës. Në vitin 2011, Samiti i Kanës i G20, nëpërmjet dokumentit: “*Plani i veprimit për zhvillimin e tregjeve të obligacioneve të shoqërive aksionare*”, theksoi rëndësinë e zhvillimit të tregjeve të obligacioneve, sidomos të obligacioneve në monedhën kombëtare të çdo vendi, si mënyrë për të përthithur kapitalet.

Për vendet në zhvillim, zhvillimi i tregjeve të obligacioneve në monedhën vendase përbën një nga përparësitë e rëndësishme, për të diversifikuar mjetet e financimit, përtej financimit nga sektori bankar dhe tregu i aksioneve. Kriza financiare i bëri bankat më konservatore në dhënien e huave, e shoqëruar kjo nga masa të forta rregullative, siç janë kërkesat e Bazel III. Në këto kushte, vendet me një treg më aktiv të obligacioneve vendase treguan se ishin më të afta të përballonin reduktimin e financimit nga sektori bankar dhe të ulin ndikimin e krizës në sistemin e tyre financiar dhe ecurinë ekonomike.

Zhvillimi i tregjeve të obligacioneve në monedhën vendase u ofron shoqërive një mundësi në rritjen e kapitalit në formën e borxhit, si burim financimi dhe njëkohësisht i ndihmon të ulin koston e sigurimit të këtij burimi. Kjo, pasi shoqëria mund të marrë hua nga investuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke shmangur tarifën që lidhen me kostot administrative të huadhënies, e gjithashtu, nivelet e interesit të këtij lloji burimi mund të bëhen më konkurruese, në krahasim



Zj. Enkeleda SHEHI

Drejtoresh e Përgjithshme
Ekzekutive

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE



Zj. Flora MUSTA

Drejtoresh

Drejtoresha e Licencimit & Monitorimit

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Obligacionet e shoqërive aksionare

Realitet dhe burim potencial për të ardhmen



Në kushtet e sistemit financiar shqiptar, zhvillimi i tregut të obligacioneve do t'i jepte frymëmarrje zhvillimit të biznesit. Gjithashtu, zhvillimi i këtij tregu do të mund të gjenerojë nivele interesi, që do të pasqyrojnë koston oportune të fondeve në çdo afat maturimi.



me interesat që ofrojnë bankat. Obligacionet, si tituj të transferueshëm, shpesh janë instrumente më tërheqëse për huamarrësit, sesa huadhënia bankare, pasi obligacionet mund të tregtohen në tregun e kapitaleve, para maturimit të tyre. Nga ana tjetër, një treg obligacionesh aktiv dhe efektiv i ofron kursimtarëve mundësi për të investuar në një spektër më të gjërë aktivesh.

Tregjet e obligacioneve përmirësojnë transparencën dhe menaxhimin e shoqërive, duke inkurajuar transparencë më të madhe, duke i nxitur ato të jenë më të hapura ndaj publikut, si

dhe duke i detyruar ato të kuptojnë më mirë veten e si rrjedhojë, të përmirësojnë menaxhimin e tyre.

Aktualisht, në kushtet e sistemit financiar shqiptar, zhvillimi i tregut të obligacioneve do t'i jepte frymëmarrje zhvillimit të biznesit. Gjithashtu, zhvillimi i këtij tregu do të mund të gjenerojë nivele interesi, që do të pasqyrojnë koston oportune të fondeve në çdo afat maturimi. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë, është i gatshëm të mbështesë çdo nismë që lidhet me emetimin e obligacioneve,

si nga shoqëritë aksionare, ashtu edhe nga qeveritë vendore. Procesi i emetimit të obligacioneve nëpërmjet ofertës private daton në fund të vitit 2011. Për gjatë 3 viteve, totali i shumës së ofruar të obligacioneve në tregun shqiptar ka qenë rreth 35 milionë euro, nga të cilat investuesit kanë nënshkruar rreth 25 milionë euro. Ndërkohë, numri i shoqërive emetuese mbetet tepër i kufizuar. Tashmë, infrastruktura ligjore, ajo institucionale dhe eksperiencia ekziston edhe për tregun shqiptar. Ligji nr.9879 datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe Ligji nr.10158 datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” përbëjnë bazën ligjore për rregullimin e emetimit dhe të tregtimit të obligacioneve. Kjo bazë ligjore mbështet krijimin e një tregu aktiv dhe eficient obligacionesh në Shqipëri.

Programi i huas (prospekti) është tipari më i rëndësishëm i obligacionit. Ai përbën kontratën që i lidh palët e ndryshme në një hua dhe përfshin detaje, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Prezantimi i të drejtave dhe i detyrimeve të tilla përbën arsyen kryesore pse emetimi i një programi huaje është i detyrueshëm. Për më tepër, programi i huas ofron siguri ligjore në përcaktimin e marrëdhënieve të palëve të përfshira. Sa më i detajuar, i qartë dhe i saktë të jetë një program huaje, më pak gjasa ka që të dalin mosmarrëveshje ndërmjet emetuesit dhe zotëruesit të obligacioneve. Në këtë mënyrë, ligji siguron një standard për mbrojtjen e zotëruesit të obligacioneve, si dhe efikasitetin e tregut. Emetuesi duhet ta pajisë investuesin me dokumentacionin objektiv për investimin. Programi i huas i ofrohet zotëruesve potencialë të obligacioneve para blerjes së obligacioneve, duke përbërë kështu një ofertë për të hyrë në marrëveshje me emetuesin. Emetimi (shpërndarja) e obligacioneve mund të bëhet nëpërmjet ofertës private, ose ofertës publike, të titujve të transferueshëm. Vlen të theksohet se, dispozitat e ligjit “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” përcështjet e ofertës publike dhe private

lidhen ngushtë me dispozitat e ligjit “Për Titujt”.

Baza ligjore në fuqi siguron mbrojtje të interesave të zotëruesve të obligacioneve, duke e vënë theksin te të drejtat e tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë të zotëruesve të obligacioneve. Sipas ligjit, organizimi i zotëruesve të obligacioneve në grup është i detyrueshëm, në çdo rast të emetimit të obligacioneve. Ky organizim shërben për të mbrojtur interesat e përbashkëta të zotëruesve të obligacioneve dhe për të lehtësuar komunikimin ndërmjet zotëruesit të obligacioneve dhe emetuesit. Nëpërmjet këtij organizimi është e mundur të rregullohen çështjet ndërmjet emetuesit dhe zotëruesve të obligacioneve, duke siguruar një zgjidhje me shumicën e votave të zotëruesve pjesëmarrës të obligacioneve. Çdo obligacion mbart të drejtën e një vote në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve.



Zhvillimi i tregjeve të obligacioneve në monedhen vendase u ofron shoqërive një mundësi në rritjen e kapitalit në formën e borxhit, si burim financimi dhe njëkohësisht i ndihmon të ulin koston e sigurimit të këtij burimi.



Për më tepër, ligji njeh përfaqësimin e interesave të zotëruesve të obligacioneve nga një agjent kompetent, gjë e cila siguron mbrojtjen e të drejtave të zotëruesve të obligacioneve. Për zotëruesit e obligacioneve është më e thjeshtë të ushtrojnë të drejtat e tyre si grup nëpërmjet një agjenti, sesa individualisht. Nëpërmjet agjentit kompetent zotëruesit e obligacioneve kanë mundësi më të mirë për monitorimin e investimeve të tyre dhe të ushtrimit të të drejtave të tyre, në rastin kur emetuesi nuk realizon detyrimet në përputhje me ligjin dhe me

programin e huas. Mbrojtja e të drejtave të zotëruesve të obligacioneve si dhe aftësia për të siguruar vijimësinë e marrëdhënieve ndërmjet emetuesit dhe investuesve varet shumë nga ushtrimi i kujdesshëm dhe i plotë i detyrave nga kujdestari. Sipas ligjit “Për titujt”, vetëm bankat kanë të drejtë të ofrojnë shërbime kujdestarie, pas marrjes së autorizimit nga Autoriteti. Kujdestarët kanë një pozicion qendror në të gjithë procesin e ruajtjes dhe shlyerjes së obligacioneve për llogari të investuesve. Transferimi eficient i letrave me vlerë ndërmjet kujdestarëve, ose ndërmjet llogarive të investuesve me të njëjtën kujdestari është parakusht për funksionimin normal të të gjithë tregut të kapitalit. Kujdestarët kryejnë një larmi të gjerë shërbimesh dhe funksionimi i plotë dhe efikas i tyre ka një rëndësi sistematike për sistemin financiar. Një nga parimet kryesore të punës së kujdestarit është veçimi i aktiveve të investuesit nga ato të kujdestarit, si një mekanizëm që shërben për të bërë dallimin e aktiveve të të dy palëve.

Në lidhje me tregtimin e obligacioneve, ligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” i referohet ligjit “Për Titujt”, Kështu, obligacionet tregtohen kryesisht në një treg të rregulluar, sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti.

Tregu i obligacioneve shërben si një burim financimi edhe për ndërmarjet e vogla dhe të mesme. Mbështetur në përparësitë që ofron obligacioni, ky treg duhet të nxitet dhe inkurajohet. Bazë për zhvillimin e tregut të obligacioneve të shoqërive aksionare është zhvillimi i tregut parësor dhe dytësor të obligacioneve të qeverisë, si dhe nxitja e ofertave private të obligacioneve të shoqërive aksionare. Ekzistenca e një lakoreje *yield*-i për obligacionet e qeverisë është një nga kushtet për zhvillimin e tregut të obligacioneve të shoqërive aksionare. Emetuesit dhe investuesit e obligacioneve të shoqërive nevojitet t'i referohen lakores së *yield*-it të obligacioneve të qeverisë, si një referencë në vlerësimin e obligacioneve të shoqërive.



BIENVENUE!

Përfitoni shumë duke paguar asgjë!



Ofertë për mikpritjen e klientëve të rinj biznese, me këto kushte për 6 muaj:

- Pa komision hapje llogarie
- Asnjë komision mirëmbajtjeje deri në dy llogari
- Paguani çdo faturë utilitare
- Taksa apo sigurime shoqërore pa asnjë komision
- Mund të merrni një kuti sigurie pa paguar qera *(kjo ofertë është e vlefshme deri në ezaurimin e këtyre kutive).*

Pavarësisht ndryshimeve të rëndësishme rregullative dhe institucionale që kanë ndodhur vitet e fundit, tregu i letrave me vlerë të qeverisë në Shqipëri mbetet përsëri në fazat e tij të para dhe i pazhvilluar. Kjo, për faktin se tregu dytësor, si ai ndërmjet bankave tregtare, ashtu dhe tregu me pakicë për individët, lenë shumë për të dëshiruar. Vlera totale e transaksioneve të tregut dytësor me pakicë, për periudhën janar – shtator 2014, ka qenë vetëm 7.6 miliardë lekë² (në përllogaritje janë marrë parasysht, shitjet nga portofoli i ndërmjetësit financiar dhe blerjet nga individët përpara afatit të maturimit), vlerë kjo shumë e vogël, në qoftë se krahasohet me totalin e portofolit të investimeve të bankave dhe institucioneve financiare. E njëjta situatë vihet re dhe në tregun dytësor ndërmjet bankave lidhur me tregtimin e letrave me vlerë përpara afatit të maturimit, ku përveç pak bankave që kanë zgjedhur të kuotojnë disa letra me vlerë të portofolit të tyre të tregtueshëm, të tjerat nuk marrin përsipër të kuotojnë, ose nuk lejohen të kenë portofol të tregtueshëm. Kjo tregon se aftësia që kanë letrat me vlerë të qeverisë shqiptare për t'u likuiduar shpejt në tregun sekondar është tepër e kufizuar. Një letër me vlerë konsiderohet likuide në qoftë se ajo shitet shpejt, pa shkaktuar ndryshim në çmimin e letrës me vlerë, si dhe në madhësi të konsiderueshme.

Mungesa e shumë portofoleve të tregtueshme dhe e kuotimeve për to në treg, e kombinuar me rregulla të forta të shmangies së rrezikut që lidhet me këto portofole, ka bërë që letrat me vlerë në tregun e brendshëm të mos tregtohen për të shumtën e rasteve dhe për shumë nga këto letra të mos ketë çmim në treg. Kjo ka çuar në rritjen e kostos për gjetjen e likuiditetit në treg, apo edhe me pamundësinë e investimeve eficientë në letrat me vlerë në tregun e brendshëm.



Z. Niko KOTONIKA, CFA
Drejtor i Thesarit
BANKA NBG SHQIPËRI



Z. Erjon TAÇE
Drejtor i Thesarit
SOCIETE GENERALE ALBANIA

Tregtarët primarë

Një ide (e njohur) për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë¹

■ ■ Një nga strukturat më të përhapura sot në tregjet ndërkombëtare është ajo e Tregtarëve Primarë (Primary Dealer). Këta tregtarë mund të jenë banka ose institucione financiare, që blejnë drejtpërdrejt nga Qeveria letrat me vlerë, me qëllim rishitjen e tyre të investuesit në tregun dytësor.

Një tjetër pengesë e hershme e zhvillimit të tregut ndërbankar të letrave me vlerë ka qenë mungesa e një sistemi që garantonte transferimin e letrës me vlerë në momentin që paguheshin fondet (*Delivery Versus Payment*). Kjo, sepse ekziston rreziku që, nëse transferohet letra me vlerë, mund të mos paguhet fondet dhe anasjelltas. Banka e Shqipërisë së shpejti do të verë në zbatim një sistem

që mundëson automatizimin e lëvizjes së fondeve me lëvizjen e letrës me vlerë, duke eliminuar në këtë mënyrë rrezikun e sipërpërmendur.

Por, duhen bërë përpjekje edhe më të mëdha për të krijuar një treg ndërbankar të letrave me vlerë. Bazuar në eksperiencën ndërkombëtare, do të vemë re se tregu i letrave me vlerë të qeverisë ka një strukturë mjaft të ndry-

¹ Opinonet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorëve dhe nuk përfaqësojnë politikën, opinionet apo pozicionin zyrtar të bankave respektive.

² Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Shtator 2014 Tregu i Letrave me Vlerë, Raport 3 Mujor.

shme nga ajo që ekziston aktualisht në Shqipëri, pasi ekziston një krijues tregu (*market maker*), që kuoton letra me vlerë të qeverisë për çdo afat maturimi.

SI MUND TË KRIJOHET NJË STRUKTURË TREGU, KU DISA BANKA TË FUNKSIONOJNË SI KRIJUESE TË VAZHDUESHME TREGU?

Një nga strukturat më të përhapura sot në tregjet ndërkombëtare është ajo e Tregtarëve Primarë (Primary Dealer). Këta tregtarë mund të jenë banka ose institucione financiare, që blejnë drejtpërdrejt nga Qeveria letrat me vlerë, me qëllim rishitjen e tyre te investuesit në tregun dytësor. Përveç rolit që kanë si ndërmjetës të drejtpërdrejtë të qeverisë me investuesit e tjerë, kanë dhe funksionin e krijuesit të tregut. Me këtë strukturë, pavarësisht privilegjeve që mund të gëzojnë disa banka si Tregtarë Primarë, atyre u lindin dhe detyrime, si: kuotimi i vazhdueshëm me të dyja krahët, blerje dhe shitje, raportimi dhe këshillimi i qeverisë, lidhur me strukturën e borxhit, promovimi i vazhdueshëm i letrave me vlerë të qeverisë në publik, etj. Megjithatë, jo në çdo situatë sistemi i Tregtarëve Primarë është më optimal.

Sipas një studimi të FMN-së³, kushtet e domosdoshme për të promovuar një sistem Tregtarësh Primarë në një vend janë:

1. Strategji konkrete e qeverisë për promovimin e letrave me vlerë të borxhit dhe parashikimi i qeverisë për kërkesën potenciale, me qëllim përputhjen e nevojave të saj për financim me kërkesën e tregut.
2. Normat e interesit duhet të vendosen në mënyrë të lirë nga tregu dhe të pasqyrojnë kërkesën dhe ofertën.
3. Zhvillimi i ankandeve në mënyrë të tillë që, çmimi të vendoset në mënyrë konkurruese dhe eficiente.
4. Ekzistenca e një plani të qartë për zhvillimin e tregut dytësor dhe ekzistenca e një kërkesë të mjaftueshme nga tregu dytësor, për të justifikuar sistemin e Tregtarëve Primarë.



Mungesa e shumë portofoleve të tregtueshme dhe e kuotimeve për to në treg, e kombinuar kjo me rregulla të forta të shmangies së rrezikut që lidhet me këto portofole, ka bërë që letrat me vlerë në tregun e brendshëm të mos tregtohen për të shumtën e rasteve dhe për shumë nga këto letra të mos ketë çmim në treg. Kjo ka çuar në rritjen e kostos për gjetjen e likuiditetit në treg, apo edhe në pamundësinë e investimeve eficiente në letrat me vlerë në tregun e brendshëm.



Sipas të njëjtit studim, në mënyrë që të funksionojë siç duhet një sistem Tregtarësh Primarë, duhet të ketë një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish në ankandet e tregut parësor për letrat me vlerë. Me gjithë vështirësitë që shfaq tregu shqiptar, për shkak të konkurrencës iminente të promovimit të mëtejshëm të letrave me vlerë të qeverisë ndaj depozitave, mendojmë se një strukturë e tillë, do të përmirësonte likuiditetin e letrave me vlerë të qeverisë. Kjo, sepse do të nxitej zhvillimi i mëtejshëm i tregut dytësor të tyre. Për më tepër, kjo do të përmirësonte plotësimin e shumave të ankandeve të qeverisë, gjithmonë duke vlerësuar paraprakisht kërkesën për letrat me vlerë.

Me qëllim që letrat me vlerë të jenë edhe të tregtueshme dhe shkëmbimi i tyre kundrejt parasë të bëhet lirshëm në treg midis agentëve të tregut që i zotërojnë, apo që duan t'i zotërojnë ato, duhet që të ketë ndërmjetësim, pra që kërkesa për para të ballafaqohet me ofertën për para. Nëse ndërmjetësimi aktualë financiarë do të mjaftohen me nivelin e sotëm të ndërmjetësimit, apo nuk kanë mundësi të tjera të rritjes së këtij niveli, një bashkësi tjetër ndërmjetësish financiarë do të duhet të hyjë në treg, e këta do të jenë Tregtarët Primarë. Ky sistem duhet lançuar në përputhje të plotë me kushtet aktuale të tregut shqiptar dhe patjetër që vënia në eficientë e një sistemi të tillë do

të kërkonte përmirësim të mëtejshme të kuadrut rregullator.

Nga ky sistem ndërmjetësimi përfitojnë të gjithë agentet ekonomike, si:

- Tregtarët Primarë, që kanë të drejtën ekskluzive të blerjes së letrave me vlerë në tregun parësor, e me pas, përkundrejt kërkesës në treg, i rishesin ato në tregun dytësor.
- Ndërmjetësit e tjerë financiarë, që sot nuk kanë një portofol të tregtueshëm të letrave me vlerë dhe që nuk janë të gatshëm të tregtojnë letra me vlerë, do të kenë mundësinë të blejnë nga Tregtarët Primarë, apo të shesin tek ata, letrat që duan. Në këtë mënyrë, do të kenë një treg real ku të mund të mbyllin pozicionet e hapura nga klientët e tyre. Rrjedhimisht, do të mund të ofrojnë një produkt më tepër klienteve të tyre, duke e mbështetur atë në një treg likuid, i cili do të krijohej nga këta Tregtarë.
- Blerja apo shitja e një letre me vlerë nga ana e individëve, apo edhe shoqërive tregtare, do të jetë një vendim marrje e lehtë sa edhe zgjedhja se ku mund të vendoset një depozitë apo ku mund të merret një hua.
- Prania e një tregu likuid të letrave me vlerë, rrit mundësitë në treg dhe kështu mund të rritej numri i ndërmjetësve të tjerë jo banka, si p.sh.: fondet e investimeve, menaxherët e aktiveve, etj.

³ Primary Dealers in Government Securities: Policy Issues and Selected Countries Experience, Marco Arnone and George Iden - March 2003.



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Lufta e monedhave”, e cilësuar ndryshe edhe si “zhvlerësimi konkurrues i monedhave”, në kuptimin e mirëfilltë të saj është tashmë një konflikt ndërkombëtar, më shumë se njëshekullor. Por çfarë është në vetvete “lufta e monedhave”, cilat janë rreziqet ekonomiko-financiare e sociale të saj, si mund të përdoret ky instrument i politikës monetare, për të krijuar supremaci ekonomike, apo aftësi të larta konkurruese; është “armë” që e përdorin vetëm Fuqitë e Mëdha, apo pasojat e saj mund t’i ndiejnë, bile rrezikshëm, edhe vendet e vogla dhe ato në zhvillim? Jo më kot, në një citim të famshëm të tij, M.A.Rothschild thoshte se: *“më jepni kontrollin e monedhës së një vendi dhe unë nuk shqetësohem më për ligjet dhe rregullat me të cilat qeveriset ai vend”*.

CFARË KUPTOHET ME TERMIN “LUFTA E MONEDHAVE”?

Në kuptimin klasik dhe standard të saj, lufta e monedhave, e shprehur shpesh dhe

Lufta e monedhave Mit apo realitet shqetësues?



Kjo është një luftë pa gjak, megjithatë cilësohet në kuptimin e plotë të fjalës “luftë”. Arma e “zhvlerësimit konkurrues” është e lehtë të përdoret, a priori mjaft efiçente për vendin që e zbaton, por gjithsesi përbën një sulm të drejtpërdrejtë për ekonominë e vendeve të tjera.



si lufta e valutave, apo lufta e përqindjeve të këmbimit, është një situatë ku vende të ndryshme zbatojnë masa specifike, kryesisht politika ekonomike e monetare, për të ulur vlerën e monedhave të tyre kombëtare, me qëllim që të favorizojnë sektorët e tyre prodhues, eksportet dhe shërbimet. Kjo është një luftë pa gjak, megjithatë cilësohet në kuptimin e plotë të fjalës “luftë”. Arma e “zhvlerësimit konkurrues” është e lehtë të përdoret, a priori mjaft efiçente për vendin që e zbaton, por gjithsesi përbën një sulm të drejtpërdrejtë për ekonominë e vendeve të tjera. Rreziku dhe pasojat më të rënda të saj burojnë nga fakti se vendet e tjera “kundërshtarë” mund t’i përgjigjen zhvlerësimit me të njëjtën armë, pra me zhvlerësim të monedhave të tyre, e në këtë kontekst, është tregtia ndërkombëtare ajo që humbet ekuilibrin, duke lëshuar sirenat e alarmit për rrezikun e shfaqjes së inflacionit. Kësaj situatë i tremben të gjithë, qofshin vende të zhvilluara, në zhvillim apo me ekonomi në rritje, si grupi BRICS.

“Përplasjet e monedhave” kanë qenë historikisht si pjesë e rëndësishme e luftës ekonomike duke u bërë bashkëshoqëruese e krizave të mëdha të kapitalizmit, sidomos në shekullin e fundit (krizat e fundit të shek.XIX-të, Depresioni i Madh i viteve 1929-33, kriza e

viteve 1970-të, kriza globale financiare e filluar në 2007-ën), duke provokuar ndjeshëm lëvizje në hierarkinë e Fuqive të Mëdha. Monedhat luajnë një rol të dorës së parë në këtë situatë sepse ato janë elementi kryesor në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, duke u shfaqur si instrument më efiçent i politikave ekonomike, që ndikon dhe njëkohësisht të lejon të vepros mbi ekuilibrat e brendshëm makroekonomikë, konsumin, kursimet



Në 2-3 dekadat në vazhdim, ekonomia botërore duket se do orientohet drejt një sistemi monetar të bazuar në tre monedha ndërkombëtare që do “luftojnë” vazhdimisht për të gjetur ekuilibrin ndërmjet tyre, ekuilibër që do pasqyrojë rivalitetin ndërmjet poleve të mëdha ekonomike të botës. Nëse nuk arrihet një koordinim efiçent i politikave monetare ndërmjet tyre, rreziku i një “luftë mjaft të ashpër monedhash” mund të bëhet shpejt realitet.



Eshtë koha për kartën tuaj të kreditit!



- **FALAS** për vitin e parë
- **Karta në dorën tuaj brenda 3 ditëve**
- **0%** për blerje në pikat e shitjes dhe Internet

Apliko ON LINE



Fibank
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

dhe investimet, bilancin tregtar, etj. Për pasojë, monedhat i kanë joshur shpesh qeveritë dhe shtetet e ndryshme, për ti manipuluar ato në mënyrë që të dalin nga kriza.

Konceptin “luftë e monedhave” e ka përdorur për herë të parë ministri brazilian i financave Guido Mantega në 27 shtator 2010, në kuadrin e shqetësimit për një vlerësim jo normal të monedhës braziliane real kundrejt dollarit amerikan dhe yuan-it japonez duke nënvizuar se “*kemi të bëjmë me politika monetare të vendeve të pasura, që çojnë drejt rivlerësimit të monedhave të ekonomive në zhvillim, çka përkthehet drejtpërdrejt si humbje e konkurrueshmërisë dhe përkeqësim të bilancit tregtar të tyre*”. Pak kohë më vonë, dhe Presidenti i FMN së asaj periudhe, Dominique Strauss-Kahn, përdori të njëjtin koncept duke shprehur shqetësimin se “*dubet marrë me shumë seriozitet kërcënimi i një luftime monedhash edhe pse duket akoma minimal. Unë mendoj se tentativat për zgjidhje të njëanshme nacionale në këtë aspekt do të bëhen më të forta*”. Kjo shprehje choc u bë kryefjala e takimit të G20 në Moskë, në shkurt 2011, e mjediset financiare e monetare u tronditën seriozisht nga një luftë që i rikthente në llogoret e krizës së depresionit të madh të viteve ‘30, që në vend të barrierave proteksioniste mund të përdorte “zhvlerësimin konkurrues”, duke prodhuar të njëjtat efekte negative. Mjaft vende të botës u trembën nga politika monetare amerikane që provokonte zhvendosjen e një fluksi të madh kapitalesh drejt ekonomive të reja, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme të cmimit të aktiveve, inflacion të lartë dhe rivlerësim artificial të monedhave të këtyre vendeve, e për pasojë ulje e përkeqësim të konkurrueshmërisë dhe bilancit tregtar të tyre. Në përpjekjen për të bërë të njëjtën gjë, këto vende mund të binin në kurthin e krijimit monetar masiv, që do t’i conte automatikisht në rritjen e çmimeve të brendshme dhe një inflacioni të lartë, të vështirë për t’u menaxhuar.

CILAT JANË VENDET QË KANË PRIRJE TË MANIPULOJNË MONEDHAT E TYRE, E T’I PËRDORIN ATO SI ARMË EFIKASE NË KËTË LUFTË MONEDHASH?

Shumë vende të botës priren të mbajnë artificialisht të ulët vlerën e monedhave të tyre, edhe pse gjendja ekonomike e financiare e tyre nuk konsiderohet problematike. Kina, me yuan-in që kontro-



Të gjitha axhustimet monetare të ekonomive më të zhvilluara të botës shkaktajnë tensione e probleme në partnerët e tyre ekonomikë e tregëtarë në zona të tjera të globit, sidomos në Azi dhe Amerikën Latine, të cilat pritet të fillojnë një kundër-ofensivë, natyrisht brenda fuqisë së tyre monetare. Ato e shikojnë me shqetësim mundësinë e forcimit të monedhave të tyre, si pasojë e politikave monetare “të të mëdhenjve”.



llohet nga Shteti, vazhdon të mbajë një kurs këmbimi, që vlerësohet se është artificialisht 30-40% më i vogël në raport me dollarin amerikan; Hong-Kongu dhe Singapori gjithashtu figurojnë në listën e vendeve që e “përdorin” monedhën e tyre në favor të proteksionizmit dhe luftës tregtare; Arabia Saudite, Rusia, etj, si vende prodhuese të naftës dhe gazit e manipulojnë monedhën e tyre; Zvicra që nëpërmjet monedhës së saj shumë të kërkuar në tregjet monetare ndërkombëtare si një nga monedhat më të sigurta, nuk heziton të “luajë” në fushën monetare për të mbrojtur ekonominë e saj; Japonia, një nga aktoret më aktive në frontin e luftës së monedhave, e shqetësuar nga një periudhë njëzetvjeçare stanjacioni dhe deflacioni shkatërrues të ekonomisë së saj, ka provuar disa herë të dobësonte yen-in, për ta nxjerrë ekonominë nga “kurthi i likuiditetit”; Britania e Madhe ka qenë shpesh herë e ngasur nga zhvlerësimi i stërlinës, në emër të “mbështetjes për ekonominë e saj në jo pak raste të lëkundur”, etj.

SHBA e ka tashmë traditë manipulimin e dollarit, sa herë është në vështirësi ekonomike e financiare, duke mbajtur një dollar relativisht të dobët, për të mbështetur rritjen ekonomike, investimeve, nxitjen e punësimit dhe konsumit. E gjithë kjo i shërben SHBA-së që të jetojë një nivel ekonomik e konsumi shumë më të lartë se mundësitë reale, po të marrim parasysh deficitet publike dhe borxhin sovran kolosal, që sa vjen dhe rritet. Megjithatë aktualisht dollari po përballlet me një prirje rivlerësuese, FED është i kujdesshëm që ky forcim mos të jetë penalizues për ekonominë amerikane, duke ndjekur me kujdes evolucionin e kursit të euros dhe yuan-it. Në këtë “luftë monetare” duket se Eurozona ka adoptuar një strategji disi më modeste, në raport me SHBA. Në fakt, Eurozona nuk duket se ka mundësi të zbatojë zgjidhje radikale,

pasi BQE e ka të fokusuar vëmendjen e saj në deficitin publik, borxhin sovran dhe kontrollin e inflacionit, duke mos patur si objektiv rritjen ekonomike dhe punësimin, të cilat mund ta nxisin të jetë më aktive në “lojën me fuqinë e euros”. Rezultat i kësaj situatë: një euro që vazhdon të mbetet monedhë e fortë, megjithë zhvlerësimin e saj me dollarin amerikan, në periudhën nëntor 2014 – janar 2015.

A MUND TË FLITET AKTUALISHT PËR NJË RIKTHIM SHQETËSUES TË LUFTËS SË MONEDHAVE?

Gjatë gjithë vitit 2014, janë vërejtur jo pak “manovra monetare”, që e bëjnë reale një frikë të tillë. Kryefjala e ditës dhe e politikave monetare nacionale duket se është “transferimi i deflacionit te të tjerët”. BQE ka dhënë shumë sinjale që, kundrejt “rrezikut të deflacionit dhe dobësive të ekonomisë së eurozonës, ka filluar të reagojë ndaj efekteve negative të euro-s së fortë dhe të veprjës në drejtim të një zhvlerësimi të saj”, në muajt në vazhdim. Efektet e para po duken; euro ka filluar një prirje zhvlerësimi kundrejt dollarit, yuan-it, sterlinës dhe yen-it. Banka Qëndrore e Japonisë, në kuadër të politikës dhe synimit “për të transferuar deflacionin jashtë Japonisë”, ka ndërmarë 2-3 muajt e fundit një politikë monetare jo-konvencionale të tipit quantitative easing, me qëllim dobësimin e yen-in dhe rrisë konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe eksporteve japoneze. Kundër-ofensiva e Bankës së Japonisë po jep rezultate për ekonominë japoneze edhe në neutralizimin e efekteve të zhvlerësimit të euros, ndërkohë që FED duket shumë më e interesuar për transferimin e deflacionit në Europë dhe Japoni. Nouriel Roubini, i cilësuar dhe si “doktor katastrofa” për faktin se ngriti i pari alarmin për krizën financiare globale të 2008, në një artikull të titulluar “Rrikthimi i luftës së monedhave” (dhjetor 2014) i referohet vendi-



mit të Bankës së Japonisë që në mënyrë surprizë forcoi politikën e saj monetare lehtësuese, duke zhvlerësuar yen-in dhe vepruar sipas strategjisë “seicili për vete”, çka prodhoi menjëherë një reaktion zinxhir në gjithë botën duke rikthyer retë e zeza të një “stuhie monetare”.

CILËT JANË PËRGJEGJËSIT E KËSAJ LUFTE TË RE MONETARE?

Gjatë 2-3 dekadave të fundit, globalizimi ka shkaktuar një përmbysje të qëndrës së gravitetit të kapitalizmit botëror drejt ekonomive të reja, që kontribuojnë sot mbi 50% të prodhimit industrial dhe eksporteve globale, si dhe zotërojnë mbi 80% të rezervave valutore botërore. Kina, Brazili dhe India janë tashmë në dhjetëshen e parë të klasifikimit botëror për PBB. Monedha ka qenë thelbi i shumë prej çekuilibrave që cuan në krizën globale të 2007-ës, e cila ende nuk duket se përfundon. SHBA ka ndjekur një politikë monetare ekspansioniste, që vlerësohet se favorizoi drejtpërdrejt fluckën spekulative që shkaktoi krizën, por që nga ana tjetër, mbështeti rritjen ekonomike dhe financoi shpenzimet marra-

mendëse të luftës në Irak e Afganistan. Në situatën e krizës gjykohet se ka luajtur një rol edhe Kina, nëpërmjet kontrollit të rreptë të kursit së këmbimit të monedhës, nënvlerësimit të yuan-it, bilancit tregtar dhe rezervës së saj valutore, që është mbi 3,800 miliardë dollarë në 2014.

Në drejtim të kundërt, yen-i japonez dhe euro ndoqën një kurs mbivlerësues, që shkaktoi një bllokim të rritjes së tyre ekonomike, uljes së konkurrueshmërisë dhe rritjen e papunësisë. Në këtë mënyrë, zhvlerësimi i monedhave në ekonomitë e reja si: Kina, Brazili, India, Argjentina, Rusia, Meksika, Nigeria, etj, si dhe mbivlerësimi i tyre në vendet e zhvilluara favorizoi një konfigurim problematik, në të cilin vendet e zhvilluara si: SHBA, Franca, Italia, Britania e Madhe, Spanja, etj., duhet të thellonin borxhin e tyre, në mënyrë që të konsumonin produkte të importuara, ndërkohë që ekonomitë e reja, bashkë me Gjermaninë duhet të kursenin për të investuar dhe eksportuar. Kriza globale e nxorri edhe njëherë në skenë fantazmën e luftës së monedhave.

Përballë thellimit të borxheve publike dhe rritjes së dobët ekonomike, vendet e

zhvilluara ju kthyen politikave monetare ekspansioniste jo-konvencionale të tipit *quantitative easing*, që konsistonin në blerjen e borxheve publike nga Bankat Qëndrore, për shkak se politikat monetare konvencionale të mbështetura në “lojën” me normën bazë të interesit ishin të paefektshme. Kjo politikë vërtet rrit borxhet shtetërore, por nga ana tjetër shton masën monetare, garanton likuiditetin e sistemit bankar, mbështet veprimtarinë ekonomike dhe shkakton zhvlerësim të monedhës. E filluar nga FED, kjo politikë u ndoq shpejt nga Banka e Anglisë, Banka e Japonisë dhe BQE nëpërmjet rifinancimit të bankave në kuadrin e LTRO (long term refinancing operation) në një shumë mbi 1,000 miliard euro, të lançuar në shtator 2012.

Të gjitha këto lëvizje me natyrë monetare po çojnë në një ristrukturim të ekonomisë botërore drejt disa qendrave të mëdha rajonale që kanë prirje të shkojnë drejt zonave të përbashkëta monetare. Ekspertët e sferës monetare vlerësojnë se panorama e ardhshme monetare, e për pasojë “ringu” i saj pritet të ketë konturet e mëposhtme: dollari amerikan do vazhdojë të mbetet monedha kryesore ndërkombëtare, por duke humbur monopolin absolut të tij; euro, në kontekstin e ndërtimit të një qeverisje ekonomike e financiare europiane dhe një roli më rregullator të BQE, do të afirmohet si një monedhë ndërkombëtare gjithësi më relative se dollari; yen japonez ka prirje të marginalizohet, në përgjigje të peshës gjithnjë e më të vogël të Japonisë në ekonominë botërore; yuan-i kinez, në pasqyrim të faktit se ekonomia kineze është ekonomia e dytë në botë dhe riorientimi i modelit ekonomik të saj drejt kërkesës së brendshme dhe shkëputjes nga varësia e dollarit amerikan, pritet të fillojë të bëhet gjithnjë e më shumë një monedhë ndërkombëtare pagesash dhe rezerve valutore.

Në 2-3 dekadat në vazhdim, ekonomia botërore duket se do orientohet drejt një sistemi monetar të bazuar në tre monedha ndërkombëtare që do “luftojnë” vazhdimisht për të gjetur ekuilibrin ndërmjet tyre, ekuilibër që do pasqyrojë rivalitetin ndërmjet poleve të mëdha ekonomike të botës. Nëse nuk arrihet një koordinim eficient i politikave monetare ndërmjet tyre, rreziku i një “lufte mjaft të ashpër monedhash” mund të bëhet shpejt realitet.

ALPHA BANK ALBANIA



Në mbështetje të shëndetësisë

Gjatë muajve të fundit të vitit 2014, banka financoi disa projekte në sektorin e shëndetësisë, si: lyerja e godinës së Qendrës Shëndetësore Kamëz, plotësimi me disa nevoja urgjente të kësaj qendre, dhurimi i një koagulometri për Qendrën Shëndetësore nr. 6 në Lagjen “Kombinat”, si dhe vendosjen e sinjalistikës në mjediset e jashtme dhe të brendshme të Spitalit Rajonal “Omer Ni-shani” në Gjirokastrë.

Mbështesim njerëzimit në nevojë

Stafi i Alpha Bank Albania përqafoi nismën e Kryqit të Kuq Shqiptar, duke mbështetur financiarisht si dhe me ushqime e veshëmbathje, familjet në nevojë.

Donacioni i fundviti

Banka mbështeti Fondacionin Spitalor “Nëna dhe fëmija”, në nismën e ndër-marrë për të blerë një pajisje grafie për të sapolindurit.



Dita Botërore e Kursimit

Në 31 tetor, Ditën Botërore të Kursimit, nën moton: “E vetmja gjë që nuk duhet të jetë kurrë në dietë janë kursimet tuaja”, Alpha Bank Albania hodhi në treg një ofertë një-ditore, me qëllim edukimin e klientëve për të kursyer.

Në ndihmë të artit

Në kuadër të 70-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, u realizua rivitalizimi i veprës skulpturore “Ujësjiellësi i Bogovës”, në sheshin qendror të qytetit të Beratit.



BKT



“Të Pastrojmë Shqipërinë”, 21 nëntor 2014, organizuar nga OJF Green Line Albania

Kjo nismë ka për qëllim të mobilizojë Shqiptarët të bashkohen në një aksion vullnetar njëditor, me qëllim pastrimin e vendit nga mbeturinat.



“The Banker” zgjedh BKT për të pestën herë si banka më e mirë në Shqipëri

Revista “The Banker”, publikim i Financial Times, e cila përzgjedh çdo vit bankat më të mira në botë, vlerësoi Bankën Kombëtare Tregtare si: “Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2014”, për të pestën herë rradhazi, në një ceremoni të zhvilluar në Londër më 27 nëntor 2014.



CREDINS BANK



Credins Bank u vlerësua me çmimin e madh kombëtar për Filantropinë për 2014, çmim ky i dhënë nga një juri e përbërë nga personalitete të ndryshme, e ngritur nga Partnerët Shqiptarë. Ky vlerësim inkurajon bankën në të ardhmen të ndër-marrë sfida edhe më të mëdha, në kuadër të përmirësimit të aspekteve të ndryshme shoqërore dhe ndërgjegjësimit të mbarë komunitetit.



CREDIT AGRICOLE



Së bashku në luftën kundër Kancerit të Gjirit

Për të dytin vit rradhazi, Banka Crédit Agricole u angazhua, së bashku me YWCA (Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare) dhe institucione të tjera mbështetëse, në veprimtaritë e organizuara gjatë kësaj periudhe, për këtë çështje kaq të rëndësishme. Gjatë muajit tetor, u kryen kontrole mjekësore dhe mamografi falas për gratë, edhe në zonat e largëta të Shqipërisë. Kjo u bë e mundur nëpërmjet një stafi të specializuar dhe dy aparatave të lëvizshme për kryerjen e mamografive. Stafi i bankës Credit Agricole, iu bashkua parakalimit simbolik organizuar në lidhje me këtë çështje të ndjeshme.

Një botë më e mirë nis me veprimet tona!

Nën moton “Njerëzit në ndihmë të njerëzve” stafi i Bankës Credit Agricole Shqipëri, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, kontribui në mënyrë vullnetare me veshje, ushqime dhe lodra për njerëzit me më pak fat sesa ata.



Përgjegjshmëria sociale

FIBANK

Në mbështetje të shtresave në nevojë

- Në periudhën e fundvitit 2014, një shumë e konsiderueshme fondesh shkuan në ndihmë të "Qendrës Ditore të Zhvillimit" për fëmijë me aftësi të kufizuar në Korçë. Kjo qendër ndihmon me terapi zhvillimi dhe mbështetje 25 fëmijë/adoleshentë dhe familjet e tyre. Nëpërmejt blerjes së 100 pikturave dhe sendeve të ndryshme, të punuara me përkushtim nga vetë fëmijët, Fibank i përdori ato si dhurata për festat e fundvitit për stafin dhe bashkëpunëtorët.

- Për të dytin vit rradhazi banka uroi kolegët dhe bashkëpunëtorët për festat e fundvitit me një kartolinë speciale, të prodhuar nga Fondacioni "Down Syndrome Albania".



Down Syndrome
Albania

ICB

Bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

- Në tetor 2014 stafi i bankës dhuroi gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

- Banka mori pjesë në fushatën e ndërgjegjësimit për ditën botërore kundra urisë (17 tetor 2014), ku punonjësit e bankës kontribuan në mënyrë vullnetare, si në vlerë monetare ashtu edhe në ushqime apo veshmbathje, në ndihmë të njerëzve të varfër.

Ndihmë ndaj shtresave në nevojë

Banka dha kontributin e saj, për të tretin vit rradhazi, në donacione ndaj Fshatit SOS, si dhe në bashkëpunim me Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA) dhe Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut.



INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA


Sponsorizim për QKR

Në vijim të nismave në ndihmë të biznesit, banka mbështeti me fonde QKR (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit), për përmirësimin e kushteve të sallës së pritjeve të individëve e bizneseve, si dhe dixhitalizimin e shërbimeve bazë, nëpërmjet një pajisjeje elektronike "Touch Screen Kiosk".



Sponsorizim për Ministrinë e Bujqësisë

Që nga viti 2014 e në vijim, banka ka në fokus zhvillimin e agrobiznesit. Në këtë kuadër, ajo mbështeti Ministrinë e Bujqësisë në projektin e ristrukturimit të godinës së tyre, Sallonin e Pritjes së Bizneseve Agro, duke qenë gjithashtu mbështetje përmes dhënies së huave të buta për bizneset e vogla dhe të mesme të këtij sektori.



Donacion për Koncertin e Bamirësisë organizuar nga Caritas

Banka mbështeti me një donacion organizimin e Koncertit të Bamirësisë: "Nuk ka rëndësi sa ndihmojmë, por sa dashuri dhurojmë tek sa ndihmojmë", nën nismën e Caritas - Albania për fëmijët dhe grupet në nevojë. Të ardhurat nga biletat shkuan në mbështetjen e Qendrës së Kujdesit Ditor për Njerëzit me Paaftësi Mendore në Fushë-Krujë.



PROCREDIT BANK ◀

Në mbështetje të prodhimit vendas “Made in Albania”

ProCredit Bank, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Durrës, organizoi një takim me përfaqësues të bizneseve fason të zonës së Durrësit. Ky takim synoi të rrisë mundësitë për informimin e këtyre bizneseve mbi disa aspekte ligjore të kontratave dhe çështje që duhet të

mbahen në konsideratë, për lidhjen e marrëdhënieve të biznesit me partnerë ndërkombëtarë. Prodhimet nën etiketën “Made in Albania” ndikojnë në zhvillimin e sektorit ku bëjnë pjesë dhe të treguesve të prodhimit lokal, si dhe rrisin vizibilitetin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.



RAIFFEISEN BANK ◀

Kënd lojrash për Shkollën Speciale “Luigj Gurakuqi”

Me rastin e festave të fundvitit, Raiffeisen Bank mundësoi një kënd lojrash për fëmijet e Shkollës Speciale “Luigj Gurakuqi” në Tiranë, i cili do të shërbejë për argëtimin dhe zbavitjen e nxënësve të këtij institucioni.

Raiffeisen Bank nderohet me çmimin “Bleta e Artë” për përgjegjësinë sociale të korporatës

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, organizoi mbrëmjen gala: “Bleta e Artë” 2014, ku u vlerësuan me çmim 15 bizneset më të mirë të vitit. Raiffeisen Bank u nderua me çmimin “Bleta e Artë” për përgjegjësinë sociale, për kontributin e saj në përmirësimin e jetës së komunitetit, nëpërmjet mbështetjes së projekteve me karakter social si dhe ato në sektorin e arsimit, shëndetësisë e mjedisit, në të gjithë vendin.



SOCIETE GENERALE ALBANIA ◀

Në mbështetje të shtresave në nevojë në Korçë

Edhe këtë vit, Banka Societe Generale Albania me rastin e festave të fundvitit, ndërmori një nismë në ndihmë fëmijëve të “Shtëpisë së Foshnjeve” dhe “Personave me aftësi të kufizuara”, në qytetin e Korçës. Më 27 dhjetor 2014, përfaqësues të bankës udhëtuan drejt këtij qyteti dhe organizuan një mbrëmje për shpërndarjen e dhuratave.



LLOGARI NË RMB

Gold Member of



SHQIPËRI



KINË



NJË LLOGARI NË VALUTË KINEZE!

Administro më mirë
kapitalin e biznesit tënd

开立中人民币账户。改善你的企业资金管理。
与中国做生意变得比以往更容易!

**BIZNESI ME
KINËN BËHET
MË I THJESHTË
SE KURRË!**

- Eliminoni risqet dhe tarifat e një këmbimi valutor të huaj.
- Eliminoni ndërmjetësit dhe kryeni veprime të thjeshta dhe të shpejta.
- Hap një llogari në RMB dhe transferoni paratë tuaja në Kinë thjesht, shpejt dhe pa burokraci.

WWW.ICB.AL



04 22 56 254



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat



TIRANA BANK

Në mbështetje të Kryqit të Kuq Shqiptar

- Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, banka festoi festën e fundvitit me fëmijët jetimë në komunitet dhe fëmijët që vuajnë nga telasemia. Rreth 150 fëmijë, nga 6 deri në 11 vjeç, festuan dhe morën lodra modeste e plot dashuri, por që sjellin aq shumë gëzim në sytë e tyre.

- Banka organizoi dhurimin vullnetar të gjakut nga të gjithë punonjësit e saj në të gjithë Shqipërinë. Kësaj nisme ju bashkuan edhe klientët të Tirana Bank, si edhe vullnetarë, të cilët ju përgjigjën pozitivisht thirrjes së saj në media.

- Në kuadër të ditës ndërkombëtare kundër urisë, banka mundësoi shpërndarjen e 100 kutive me ushqime, të cilat ju dhuruan të moshuarve të vetmuar.

Tirana Bank Mendon Rozë

Në muajin tetor, banka mbështeti fushatën ndërgjegjëse kundër kancerit të gjirit të Shoqatës Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA). Gjithashtu, stafi i saj mori pjesë në takime ndërgjegjëse, si edhe në maratonën e organizuar prej YWCA-së.

Në mbështetje të nismës: "Vrapoj maratonën e parë (42km)"

Tirana Bank, për të mbledhur fonde në ndihmë të fëmijëve me HIV/AIDS, mbështeti nismën e Albi Grevës: "Vrapoj maratonën e parë (42km)", së cilës ju bashkuan edhe punonjësit e bankës, të cilët gjithashtu ndihmuan në mbledhjen e fondeve për këtë nismë humane.



UBA

United Bank of Albania dhuron!

Këtë fund viti, United Bank of Albania (UBA), u erdhi në ndihmë fëmijëve me Sindromën Down me blerjen e kartolinave të fundvitit nga Fondacioni "Down Syndrome Albania" (DSA), si dhe organizimin e një veprimtarie për fëmijët e këtij Fondacioni, ku u shpërndanë dhe dhurata.



VENETO BANKA

Partner financiar i Agjensisë Kombëtare të Turizmit

Veneto Banka mbështeti financiarisht fushatën promovuese të informimit, e ideuar dhe konceptuar nga ana e Agjensisë Kombëtare të Turizmit.



Sponsor i Superkupës së Shqipërisë

Veneto Banka sponsorizoi takimin përmblylës të dy garave më të rëndësishme të futbollit shqiptar, Superkupën e Shqipërisë.





nga Z. Maks LEKSANI

Drejtor i Sigurisë së TI dhe Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit
BANKA INTESA SANPAOLO - SHQIPËRI
Nënkryetar i Komitetit të Sigurisë së TIK,
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Siguria e informacionit në sektorin financiar është një aspekt strategjik që po përvijohet dhe skalitet gjithnjë e më shumë në veprimtarinë bankare, e që mund të bëhet një faktor përcaktues në skenarin konkurrues të botës së biznesit. Në një këndvështrim më gjithëpërfshirës, menaxhimi i sigurisë së informacionit, nënkupton gjetjen e përgjigjeve ndaj kërkesave gjithnjë në rritje që tregu u imponon bankave, si p.sh: ndaj kërkesave të institucioneve qeveritare, ndaj kërcënimeve që vijnë prej diversifikimit dhe zgjerimit të kanaleve ekzistuese dhe atyre të reja të sistemeve të pagesave, si dhe ndaj mbrojtjes së informacionit dhe menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit bankar në përgjithësi. Këto janë vetëm disa nga aspektet, që i përkasin këtij vizioni. Në këtë kontekst, bankat po gjenden gjithnjë e më shumë përballë domosdoshmërisë për një ekuilibër optimal midis nevojës për kërkesa sigurie dhe asaj për shërbime efikase dhe fleksibël ndaj klientelës së tyre.

Në ditët e sotme, po vërehet një prirje gjithnjë në rritje e veprimtarive kriminale ndaj të dhënave dhe informacionit, të cilat konsiderohen nga ana e kriminelëve si me

Administrimi i sigurisë së informacionit në strukturat organizative të bankës

Deri kohët e fundit, fokusi i sigurisë ka qenë i përqendruar mbi mbrojtjen e sistemeve të TI-së, që përpunojnë dhe ruajnë pjesën më të madhe të informacionit, sesa mbi vetë të dhënat dhe informacionin. Megjithatë, kjo qasje është tejet e kufizuar... për të arritur efektivitete dhe qëndrueshmëri në ditët e sotme siguria e informacionit duhet të trajtohet në nivelet më të larta të një organizate biznesi.

rrezik të ulët dhe me fitim të lartë. Procesi evolutiv i ofertës së produkteve financiare, i bazuar ngushtësisht edhe mbi teknologjinë e informacionit, kërkon zgjidhje të sigurisë së informacionit dhe të vazhdimësisë së biznesit gjithnjë e më efikase. Është pikërisht kjo pjesëmarrje e rëndësishme e teknologjisë së informacionit, në procesin e ndërveprimit me klientin, qoftë ky individ ose biznes, që e shndërron garantimin e një niveli të pranueshem të sigurisë së informacionit, në një element përbërës thelbësor të ofertës së institucioneve financiare.

QEVERISJA E INTEGRUAR E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Në nivel strategjik, një nga shqetësimet kryesore të drejtuesve ekzekutivë është pikërisht nevoja për të qenë të sigurt ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit, që në një spektër më të gjerë nënkupton përmbytjen e kërkesave specifike ndaj sigurisë, të përcaktuara nga një vizion kompleks dhe gjithëpërfshirës. Për këtë arsye është e qartë se në ditët e sotme siguria e informacionit është gjithnjë e më shumë një çështje e kompetencës së menaxhimit të lartë, pasi kërkon një rakordim të efektiviteteve të veprimtarive parandaluese si dhe kundërmarrjeve specifike, përkundrajt optimizimit të burimeve të disponueshme, të cilat duhen zbatuar në çdo nivel organizativ dhe operativ të bankës.

Qasja e integruar për administrimin e sigurisë së informacionit në banka ka për qëllim pikërisht ndërmjetësimin midis kërkesave të ndryshme, madje ndonjëherë kontradiktore, midis biznesit dhe sigurisë,

duke shmangur kështu situata reciprokisht bllokuese si dhe mungesa në koherencë dhe konstistencë. Realizimi dhe adoptimi i një qasjeje të integruar të sigurisë bën të mundur përqendrimin e përgjegjësisë të strukturave të ndryshme organizative të bankës, përsa i përket sigurisë, në një strukturë të vetme ndërlidhëse në nivel të lartë menaxhimi, e si rrjedhojë, edhe arritjen e optimizimit të proceseve respektive të sigurisë. Deri kohët e fundit, fokusi i sigurisë ka qenë i përqendruar mbi mbrojtjen e sistemeve të TI-së, që përpunojnë dhe ruajnë pjesën më të madhe të informacionit, sesa mbi vetë të dhënat dhe informacionin. Kjo qasje është tejet e kufizuar për të arritur nivelin e integritetit, sigurimit të proceseve si dhe të mbrojtjes në përgjithësi që nevojitet sot. Për të arritur efektivitete dhe qëndrueshmëri në ditët e sotme, siguria e informacionit duhet të trajtohet në nivelet më të larta të një organizate biznesi.

Qasja e nevojshme për menaxhimin e sigurisë së informacionit kërkon vizion të zgjeruar, sipas të cilit informacioni në një organizatë dhe njohuritë e bazuara në të duhen mbrojtur, pavarësisht nga mënyra se si trajtohet, përpunohet, transportohet, apo ruhet ai. Ky vizion adreson tërësinë e të gjithë rreziqeve, përfitimeve si dhe proceseve që përfshihen, ndaj të gjitha burimeve të informacionit. Siguria e informacionit, ashtu si me burimet e tjera kritike organizative, duhet të trajtohet në një nivel global organizativ. Siguria e informacionit nuk është vetëm një çështje teknike, por një sfidë biznesi dhe mirëqeverisjeje, që përfshin menaxhimin e duhur të rrezikut

të informacionit, raportimin dhe përgjegjësitë respektive. Në këtë kontekst, siguria efektive e informacionit kërkon përfshirjen aktive të drejtuesve të lartë në vlerësimin e rreziqeve emergjente si dhe në përcaktimin e kundërpërgjigjes organizative ndaj tyre. Kjo qasje e integruar nënkupton gjithashtu ripërcaktimin e proceseve, me qëllim koordinimin metodologjik të veprimtarive ndërorganizative, të tilla si: menaxhimi i rrezikut të lidhur me informacionin në të gjithë elementët përbërës të tij (strategjik, financiar, operativ dhe ligjor), menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit, menaxhimi i sigurisë teknike dhe logjike të informacionit, lufta kundra mashtrimeve, privatësia, si dhe të veprimtarive të tjera të rëndësishme. Për shembull, një aspekt i rëndësishëm për bankat sot është "analiza shkencore e krim-it", sipas të cilës kërkohet të hetohen dhe dokumentohen siç duhet ngjarjet kriminale dhe mashtrimet, si dhe sulmet e ndryshme ndaj informacionit.

Secila prej këtyre veprimtarive kërkon marrëdhënie të forta dhe role e përgjegjësi të mirëpërcaktuara midis Sigurisë së Informacionit, si një strukturë qendrore organizuese dhe aktorëve të tjerë/zotëruesve të proceseve të biznesit, të tillë si: Teknologjia e Informacionit, Menaxhimi i Rrezikut, Burimet Njerëzore, Auditimi, Departamenti Ligjor, Përputhshmëria Ligjore, Menaxhimi i Projekteve, si dhe grupet e jashtme të interesit. Kjo qasje sjell përfitime të qarta e të rëndë-

sishme për një organizatë, të tilla si:

- Rritja e parashikueshmërisë dhe zvogëlimi i pasigurisë së operacioneve të biznesit, duke ulur rreziqet e lidhura me sigurinë e informacionit, në nivele të përcaktueshme dhe të pranueshme,
- Mbrojtja nga rritja e mundshme e përgjegjësiwe civile ose juridike, si pasojë e pasaktësisë së informacionit apo mungesës së kujdesit të duhur,
- Garantimi i efektivitetit të politikave të sigurisë së informacionit si dhe zbatimit respektiv,
- Krijimi i një themeli solid për menaxhimin eficient dhe efektiv të rrezikut të informacionit,
- Reagimi i shpejtë ndaj incidenteve, lidhur me sigurimin e informacionit,
- Një nivel i caktuar sigurie, që vendimet kritike nuk do të bazohen mbi informacione të mangëta, gjatë kryerjes së veprimtarive kritike të biznesit.

Nje faktor kritik i suksesit përse i perket administrimit dhe menaxhimit te sigurisë së informacionit, është angazhimi dhe mbështetja e vazhdueshme dhe e dukshme e sigurisë nga ana e drejtimit të lartë ekzekutiv të organizatës; gjithashtu faktorë të tjerë kritike jane: (i) objektiva dhe veprimtari të sigurisë, që bazohen në objektivat dhe kërkesat e biznesit, (ii) menaxhim i centralizuar, i mbështetur në një strategji dhe politikë të përbashkët, përgjatë gjithë organizatës, (iii) ndërmarre vetëm e veprimtarive të nevo-

jshme, duke shmangur kontrollin e tepruar dhe harxhimin e burimeve të vlefshme, (iv) përputhja me filozofinë dhe kulturën e organizatës dhe se fundmi të kujtuarit se (v) siguria e informacionit është një proces i vazhdueshëm.

Kërkesa në rritje në sektorin financiar për një menaxhim të mirëstrukturuar dhe të integruar të sigurisë së informacionit në strukturat organizative është një kundërpërgjigje e detyrueshme, në mënyrë që të parandalohen fenomenet kriminale kundrejt informacionit bankar.

Këto fenomene janë në rritje të vazhdueshme, për shkak të zgjerimit të komunikimit elektronik, sistemeve të reja të pagesave si dhe hapjes së Shqipërisë si vend kandidat ndaj Bashkimit Europian, një veprim që përveç një serie efektesh pozitive mbart domosdoshmërisht disa pasoja, si p.sh. një ekspozim më të madh ndaj krimeve të lidhura me informacionin. Është detyrë e sektorit bankar të krijojë, pozicionojë dhe përmirësojë strukturat e duhura të sigurisë së informacionit, të afta të përballojnë të tilla efekte negative, jo vetëm thjesht si një përmbushje e dispozitave rregullatore dhe ligjore, por kryesisht për të garantuar konfidencialitetin, gatishmërinë dhe integritetin e informacioneve dhe të dhënave të klientëve, sikurse dhe reputacionin e tyre si institucione ku jepen garanci serioze për mbrojtjen e informacionit.

Grupet e interesit për sigurinë e informacionit	Strategjia e Sigurisë së Informacionit	Buxheti i Sigurisë së Informacionit	Plani i Sigurisë së Informacionit	Politikat e Sigurisë së Informacionit	Kërkesat e Sigurisë së Informacionit	Sensibilizimi për Sigurinë e Informacionit	Rishikimet e Sigurisë së Informacionit	Katalogu i Sigurisë së Informacionit	Profili i Rrezikut të Informacionit	Progres - raporti i Sigurisë së Informacionit
Të brendshëm: ndërmarrja										
Bordi	P			M		P	M		A	
Drejtori i përgjithshëm (CEO)	P			A		P	M		P	
Drejtori financiar (CFO)		A		P		P			P	
Drejtori i sigurisë së informacionit (CISO)	O	P	O	O	A	A	A	A	P	P
Komiteti drejtues i sigurisë së informacionit (ISSC)	A	O	A	P	P	I	P	M	P	P
Zotëruesit e proceseve të biznesit				P	O	P		P	P	
Drejtori i burimeve njerëzore (HR)				P		P				
Drejtori i teknologjisë së informacionit (CIO) / menaxheri i it-së	P	O	P	P	P	P	M		P	P
Struktura e sigurisë së informacionit (TI)	P	P	P	O	P	O	O	O	O	O
Të jashtëm										
Investuesit						M				
Siguruesit						M	M		M	
Rregullatorët		M				M	M			
Partnerët e biznesit						M	M			
Shitësit/furnitorët						M				
Audituesit e jashtëm		M				M	M		M	M

Treguesi i natyrës së marrëdhënies së grupeve të interesit, për secilin lloj informacioni - Burimi: Isaca.org
A - Aprovues; O - Origjinues; M - Marrës i llojit të informacionit; P - Përdorues i llojit të informacionit

KREDIA PERSONALE

ME INTERESAT ME TE ULTA

FIKSE 10% NE LEK



INTESA SANPAOLO BANK

KREDIA PERSONALE PER ÇDO QELIM

- Pa garanci
- Me afat deri në 7 vjet
- Deri në shumën max. 1.000.000 lek / 10.000 euro

NJE BOTE MUNDESISH REALE

Intesa Sanpaolo Group
Official Global Partner




MILANO 2015

CALL CENTER
08006000 (FALAS)
+355 4 2276000/222/223
+355 692080903

www.intesasnpaolobank.al

BANK OF INTESA SANPAOLO GROUP
INTESA  SANPAOLO



nga Zj. Evis ÇELIKU

Drejtoare e Divizionit të Riskut Retail
RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI

Shitja e borxheve, apo huave, është një strategji e përdorur gjithnjë e më shumë nga bankat në botë. Në realitetin ndërkombëtar ajo përqendrohet, por nuk kufizohet, në portfolin e huave të klasifikuara si “me probleme”. Ajo mundëson kalimin e gjithë të drejtave dhe detyrimeve të lindura nga lidhja e një kontrate huaje, ndërmjet një ose disa huamarrësve dhe një huadhënësi, të një huadhënësi i ri. Ky i fundit zëvendëson atë ekzistues dhe i bart këto të drejta e detyrime, deri në ripagimin e plotë të detyrimit të huas.

Mbledhja e huave në vonesë, ndonëse një proces mjaft i rëndësishëm në ciklin e huas, nuk mund të konsiderohet si një veprimtari kryesore dhe e qenësishme për bankat tregtare. Ajo është pjesë e ciklit të këtij biznesi, që një pjesë e huamarrësve të saj, për arsye të ndryshme, të mos shlyejnë në mënyrë të plotë dhe

Shitja e huave (me probleme)

Një mekanizëm që krijon vlerë të shtuar për bankën



Shitja e huave mund të realizohet me një transaksion të vetëm, ose me shumë transaksione vazhduese, të rregulluara në një kontratë të vetme. Në parim është një proces fleksibël, i rënë dakord mes shitësit dhe blerësit.



korrekte detyrimet kontraktuale, duke krijuar kështu bazën potenciale për shitjen e huave me probleme. Shitja e këtyre huave, në parim, synon rritjen e menjëhershme të fondeve likuide (*cash-it*), çliron shitësin nga kostot që shoqërojnë procesin e rikuperimit dhe ul nivelin e huave me vonesë/problematike në bilancin e bankave.

Nëse banka në një moment të caktuar të jetës së huas vlerëson që, shanset për ripagim janë në nivele të tilla që nuk



Një element kyç i këtij procesi është përcaktimi i profilit të rrezikut të portfolit subjekt shetjeje, si elementi kryesor në përcaktimin e çmimit të transaksionit. Mungesa e informacioneve publike në realitetin shqiptar si ato të: adresave, telefonisë lëvizëse, punësimit apo ripagimit të detyrimeve, e përkeqëson edhe më shumë këtë profil.



justifikojnë kostot e ndjekjes, atëherë ajo vendos ta shesë huan problematike sot, kundrejt një çmimi i cili justifikohet në kohë si një e ardhur alternative më e mirë, kundrejt totalit të të ardhurave dhe shpenzimeve, nese kjo hua do të mbahej nën administrimin e bankës, me qëllim rikuperimi.

Sistemi bankar në Shqipëri vetëm vitet e fundit është bërë më agresiv dhe ka paraqitur në treg mjete e teknika të reja, në kuadër të dimensionit të mbledhjes së huave me probleme. Gjatë kësaj periudhe hyjnë në treg aktorë të rinj, si: shoqëritë private të mbledhjes së huave me probleme, zyrat përmbarimore private që zëvendësuan ato shtetërore, ndërkohë që dhe kuadri ligjor për ekzekutimin e kolateralit u përmirësua. Kjo ndihmoi në konsolidimin e mesazhit në treg – bankat kërkojnë ripagimin e huave, ato nuk harrohen – mesazh i cili ishte i vakët për një periudhë të gjatë, provokuar kjo edhe nga një situatë ekonomike në rritje në vend, deri para krizës globale.

Në vendin tonë dhe në Raiffesien Bank - Shqipëri, ky proces mbuloi pjesën e portfolit të huave të pasiguruara dhënë individëve dhe mikrobizneseve, i cili ishte në vonesë ripagimi dhe për të

cilët banka kishte ezauruar të gjitha hapat për mbledhjen e detyrimit kreditor. Sigurisht që pyetjet rreth tij ishin të shumta, aq më tepër nëse merret në konsideratë fakti që, një shitje e tillë ishte për herë të parë në tregun bankar në Shqipëri. Po kur është momenti i duhur për të shitur një hua? Cilat janë rreziqet që e shoqërojnë atë? Si do të rregullohet juridikisht procesi? Nga nis procesi për të shitur huan? A ka treg për këtë transaksion në Shqipëri? Si do reagojë tregu pas kësaj?

Fatmirësisht, për Raiffesien Group kjo nuk ishte eksperiencia e parë dhe ekspertiza e grumbulluar në rrjet shërbeu si një bosht i rëndësishëm gjatë këtij procesi. Ishte pikërisht ky standard grupi, i cili synoi jetësimin e kësaj strategjie edhe në Shqipëri, duke shënuar kështu dhe shitjen e parë të portofolit të huave me probleme në vend. Shitja e huave mund të realizohet me një transaksion të vetëm, ose me shumë transaksione vazhduese, të rregulluara në një kontratë të vetme. Në parim është një proces fleksibël, i rënë dakord mes shitësit dhe blerësit.

Ndër përfitimet kryesore që ofron ky mekanizëm mund të përmenden:

- Të ardhurat nga huat me probleme
- Reduktimi i kohës dhe kostove administrative e menaxheriale në rekurrim
- Fokusimi i burimeve të brendshme në huat e rregullta
- Fitimi i një mjeti shtesë në koleksionin e mjeteve për mbledhjen e huave
- Përmirësimi i hyrjeve të fondeve likuide (cash-it), si dhe
- Përmirësimi i parametrevë të rrezikut të portofolit të huas.

Një element kyç i këtij procesi është përcaktimi i profilit të rrezikut të portofolit subjekt shitjeje, si elementi kryesor në përcaktimin e çmimit të transaksionit. Mungesa e informacioneve publike në realitetin shqiptar si ato të: adresave, telefonisë lëvizëse, punësimit apo ripagimit të detyrimeve, e përkeqëson edhe më shumë këtë profil. Nga ana tjetër, kjo peshohet dhe me nivelin e zhvillimit të tregut në vetvete, ku dihet që



konkurrenca është shtytja më e mirë, për një proces i efektshëm dhe afatgjatë. Në kohën e këtij transaksioni, ky treg ishte joekzistent dhe na u desh të iniciojmë jo vetëm interesin për të, por dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse, që të realizonim kuadrin e plotë për shitjen e huave me probleme.

Aktualisht nuk ka ndonjë udhëzues, apo rregullore të publikuar nga Banka e Shqipërisë, që të rregullojë specifikisht këtë veprimtari. Ndaj për realizimin e tij u përshtatën ato ekzistuese, të cilat prodhuan një version konservator të rregullimit të tij, e cila kufizonte blerësit vetëm te ata që kishin një licencë huadhënieje, gjë që nuk është praktikë në vendet e zhvilluara. Përmirësimi i kuadrin ligjor dhe rregullativ, në lidhje me këtë transaksion specifik është i nevojshëm, për të lehtësuar e qartësuar operatorët ekzistues, pse jo dhe të rinj, duke rritur kështu konkurrencën dhe duke i'u përqasur praktikës së vendeve më të zhvilluara.

Tashmë mund të themi që procesi dhe mjetet e rikuperimit të huave me probleme në Raiffesien Bank - Shqipëri,

janë në nivele të avancuara e të ngjashme me ato të bankave ndërkombëtare në Europë. Ajo mundëson disa alternativa zgjidhjeje ndaj ngërceve financiare të krijuara nga cilësia e ripagimit të huave, të ndikuara këto jo vetëm nga profili i huamarrësve dhe politikave të bankës, por edhe nga situatat ekonomike në vend dhe në rajon. Tregu reagoi pozitivisht dhe pjesë e rëndësishme për këtë është dhe profili profesional i blerësit, në administrimin e këtij portofoli, pas blerjes së tij nga Raiffesien Bank.

Sot, ne më shumë se një vit nga mbyllja e këtij transaksioni, mund të deklarojmë që jemi krenarë që e çuam deri në fund, pavarësisht pasigurive dhe rreziqeve që e shoqëronin këtë transaksion, si hera e parë. Sigurisht, ashtu si edhe çdo proces tjetër, eksperiencia krijon mundësi për përmirësime, gjë që do t'i sigurojmë në transaksionet e ardhshme. Ne besojmë ky mjet për rikuperimin e huave do ketë të ardhme në Shqipëri, pasi kudo ku ka huadhënie ka rrezik dhe ku ka rrezik ka mundësi rikuperimi, edhe nëpërmjet shitjes së huave.

TRAJNIME

TAKIM-DISKUTIMI MBI BAZEL II, 22 - 23 TETOR 2014

AAB, në bashkëpunim me ekspertët e Moody's Analytics (UK), organizoi tre seminare mbi Bazel II, me pjesëmarrjen e bankave tregtare dhe përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë. Seminari u përqendrua në praktikatat më të mira për zbatimin e Bazel II/III dhe u ndoq nga 45 pjesëmarrës nga bankat anëtare.



“ZBULIMI I MASHTRIMIT: SFIDAT NË NJË MJEDIS TË VËSHTIRË TË BIZNESIT”, 24 - 25 NËNTOR 2014

AAB, së bashku me Institutin Shqiptar të Audituesve të Brendshëm (AIIA), organizoi një seminar trajnues dyditor, lidhur me Zbulimin e Mashtrimit. Gjatë trajnimit u prezantuan praktikatat aktuale më të mira, të mbështetura në raste studimore, të cilat ndodhin në vendet e rajonit. Trajnimi u ndoq nga 22 përfaqësues të bankave anëtare.



MENAXHIMI I SHITJES SË SUKSESSHME TË KARTAVE, 3-4 DHJETOR 2014

AAB organizoi një takim-diskutim, të ofruar falas nga VISA për bankat anëtare, të cilat janë emetuese të kartave të kësaj shoqërie. Objektivi i këtij takimi ishte sigurimi i mbështetjes për bankat në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme, për të gjetur mënyrat më efektive për shitjen e produkteve të kartës VISA. Në këtë takim morrën pjesë 30 pjesëmarrës.





AAB

Mundëson pjesëmarrjen në trajnimet cilësore zhvilluar nga ATTF, Luksemburg.

AAB është partneri i vetëm zyrtar për Shqipërinë i Financial Technology Transfer Agency (ATTF/ <http://www.attf.lu/>) në Luksemburg, që prej shtatorit të vitit të kaluar. Ky institucion ka objektiv të sigurojë mbështetje teknike për çështjet financiare si edhe të ndajë eksperiencën e qendrës financiare të Luxembourg-it me vendet partnere. AAB do të funksionojë si zyrë koordinimi për Shqipërinë dhe do bashkëpunojë me ATTF në kuadër të trajnimeve të ndryshme që ofrohen në fushën financiare. Trajnimet e ofruara janë të një niveli të lartë dhe me kosto shumë të përballueshme pasi pjesërisht sponsorizohen nga Ministria e Financave të Luksemburgut. Aplikuesit nga Shqipëria duhet të dërgojnë aplikimet tek AAB dhe pas aplikimit kandidatët do të përzgjidhen në bazë të profilit, eksperiencës, pozicionit të tyre në institucionin financiar përkatës.

Aktualisht në trajnimet e ofruara nga ATTF kanë marrë pjesë 8 specialistë të bankave tregtare dhe rreth 10 të tjerë janë përzgjedhur për trajnimet që vijnë në muajt e parë të vitin 2015.

Gjatë vitit 2014 bankierët Shqiptarë morën pjesë në trajnimet :

1. "Financimi i Ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla" - i organizuar në Luksemburg nga 6-14 tetor 2014
2. "Parandalimi i pastrimit të parave", Niveli II & Kurs përgatitor për provimet CAMS® certification organizuar në Luxembourg nga 20 deri 27 tetor 2014
3. Seminarin ndërkombëtar "CAMBOC - Capital Markets Back-Office Certification Programme Level II: Mastering Securities Back-Office Operations", organizuar në Luksemburg nga 24 deri 28 nëntor 2014.

Gjatë vitit 2015, ATTF do të organizojë trajnimet në vijim:

1	Compliance Certified Programme	02 - 11 shkurt 2015
2	Capital Markets Back-Office Certified Programme : CAMBOC Level I: Fundamentals in Securities Settlement, Clearing and Custody	02 - 06 mars 2015
3	Financing SME: From Business to Credit Assessment and Management	09 - 13 mars 2015
4	Anti-Money Laundering Certified Programme: Anti-Money Laundering & Terrorist Financing Foundation	20 - 24 prill 2015
5	Certified Private Banker: Foundation Level	04 - 12 maj 2015
6	Human Resources Management for Line Managers	17 - 22 maj 2015
7	Capital Markets and Financial Instruments Certified Programme: CAMFIN Certificate: Capital Markets and Financial Instruments,	01 - 08 qershor 2015
8	A Strategic Bank Management Review	08 - 12 qershor 2015
9	Risk Management Certification Programme: Preparing to the Financial Risk Manager FRM® Exam Part I of GARP	10 - 17 tetor 2015
10	Anti-Money Laundering Certified Programme: Anti-Money Laundering Level II Preparation Course to the "Certified AML Specialists-CAMS® Certification"	12 - 19 tetor 2015
11	Risk Management Excellence: Connecting Luxembourg to Leading MFIs	16 - 20 nëntor 2015
12	Strategy, Performance and Risk Management in Microfinance – he SIMFI interactive Training Course	23 - 27 nëntor 2015
13	ACI Diploma	30 - 08 dhjetor 2015

Për më shumë informacion lidhur me trajnimet që ofron ATTF ju lutem kontaktoni:

JUNIDA TAFAJ (KATROSHI)

TRAINING COORDINATOR
ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS

Rr. Ibrahim Rugova • Nr. 5 • SKY TOWER • A 9/3 • Tiranë
+355 4 2280 371 7 +355 4 2280 359
junida.katroshi@aab-al.org • www.aab.al

AAB Aktivitete

KOMUNIKIMI

Në kuadër të zhvillimit të strategjisë së komunikimit nëpërmjet mediave sociale, AAB krijoi faqet e saj zyrtare në rrjetet sociale, Facebook, LinkedIn dhe Youtube. Faqja mund të vizitohet duke klikuar në linkun më poshtë:

<https://www.facebook.com/www.aab.al>



EDUKIMI FINANCIAR

AAB, në bashkëpunim me rrjetin Neptun ekspozoi në mjediset e Qendrës Tregtare TEG broshurën mbi "Kartat Bankare", publikuar dhe promovuar vitin e kaluar nga AAB-ja, në forumin e tretë kombëtar të kartave. Ky projekt ka për qëllim të informojë zotëruesit aktualë dhe të mundshëm potencialë të kartave bankare mbi të përdorimin, përfitimet dhe kushtet e këtij produkti.



AAB prezantoi projektin e serive video, të quajtur "Banka ime". Dy videot e para të shfaqura në faqen e internetit të AAB-së, YouTube dhe Facebook, përkatësisht "Kartat Bankare" dhe "Metodat e pagesës", kanë për qëllim të japin detaje dhe informacion të thjeshtë për klientët e rinj dhe ekzistues të bankave. Projekti përfshin realizimin e 10 videove të tjera, kryesisht të fokusuara në bankingun me pakicë dhe për individët.

Për më tepër informacion mund të shikoni **Shoqata Shqiptare e Bankave / AAB** në Youtube.



"Në kuadër të përmirësimit të situatës në lidhje me dhënien e informacionit në fazën e publicitetit dhe parakontraktore, përpara ofrimit të një kredie konsumatore nga bankat që operojnë në Shqipëri, AAB në konsultë edhe me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit botoi broshurën informative "Kredia Konsumatore"

AAB beson se me ndihmën e kësaj broshure dhe udhëzimet e bankave tregtare, klienti bankar do të jetë në gjendje të menaxhojë më mirë financat e tij.

"Një klient i edukuar, është gjithmonë një klient më i mirë"



